



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/14
Datë: 28.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-070 për Mbeturina, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia (2021-2030) dhe Plan i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë.
2. Për zbatimin e kësaj Strategjie dhe Planit të Veprimit, obligohen: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, komunat dhe institucionet tjera të përcaktuara në këtë Strategji dhe Plan të Veprimit.
3. Me këtë dokument strategjik synohet të arrihet zhvillimi i integruar dhe i qëndrueshëm i menaxhimit të mbeturinave i cili ndikon në ruajtjen e shëndetit publik, zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.
4. Ky dokument synon t'i trajtojë të metat dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i përcaktuar dhe realizuar katër (4) objektivat strategjike të cilat janë paraparë me këtë Strategji. Realizimi i këtyre objektivave strategjike do të luajë rol në shtyrjen e Kosovës përpara drejt zhvillimit të ekonomisë qarkore.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Strategjia (2021-2030) dhe Plan i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë



Prishtinë

Tabela e përmbajtjes

TABELA E PËRMBAJTJES	2
AKRONIMET	4
PËRKUFIZIMET	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
1. HYRJE	11
2. METODOLOGJIA	12
3. HISTORIK	14
3.1 PRODHIMI I MBETURINAVE	14
3.2 FAKTORËT MAKROMJEDISORË	15
3.2.1 FAKTORËT POLITIKË	15
3.2.2 FAKTORËT EKONOMIKË	15
3.2.3 FAKTORËT SOCIALË	16
3.2.4 FAKTORËT TEKNOLOGJIKË	16
3.2.5 FAKTORËT MJEDISORË	16
3.2.6 FAKTORËT LIGJORË	17
3.3 GJENDJA EKZISTUESE	17
3.3.1 MBETURINAT E NGURTA KOMUNALE	17
3.3.2 MBETURINAT E NDËRTIMIT DHE RRËNIMIT	19
3.3.3 MBETURINAT BUJQËSORE DHE TË KAFSHËVE	20
3.3.4 AUTOMJETET	20
3.3.5 GOMAT	21
3.3.6 PAJISJET ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE	21
3.3.7 VAJRAT	22
3.3.8 BATERITË	22
3.3.9 LLUMI	23
3.3.10 MBETURINAT INDUSTRIALE DHE MINERARE	23
3.3.11 MBETURINAT E RREZIKSHME	24
3.3.12 MBETURINAT E KUJDESIT SHËNDETËSOR	24
3.4 ANALIZË	25
4. OBJEKTIVAT	29
4.1 VIZIONI	29
4.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE SPECIFIKE	29
4.3 OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: SHËRBIMET DHE INFRASTRUKTURA	31
4.3.1 SHËRBIMET E MBLLEDHJES SË MBETURINAVE	32
4.3.2 QENDRAT E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETURINAVE	32
4.3.3 MBETURINAT E TJERA	34
4.4 OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: PROFESIONALIZIMI	36
4.4.1 NDËRTIMI I KAPACITETEVE	36
4.4.2 NJOHJA E SEKTORIT	37
4.4.3 HULUMTIMI DHE ZHVILLIMI	38
4.5 OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: RREGULLIMI DHE KONTROLLI	38

4.5.1	SISTEMIN INFORMATIV PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE	38
4.5.2	DHËNIA E LICENCAVE DHE LEJEVE	39
4.5.3	MEKANIZMAT E ZBATIMIT	40
4.6	OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: EKONOMIA QARKORE	40
4.6.1	VETËDIJESIMI DHE EDUKIMI	41
4.6.2	PARANDALIMI I MBETURINAVE	41
4.6.3	RIPËRDORIMI DHE RICIKLIMI	42
5.	<u>ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI</u>	44
5.1	PARIMET	44
5.2	CAQET	45
5.3	ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI	47
6.	<u>NDIKIMI BUXHETOR</u>	51
7.	<u>PËRAFRIMI ME OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM</u>	52
8.	<u>PLANI I VEPRIMIT</u>	56
7.1	PLANI I VEPRIMIT 2021-2023	56
7.2	ORARI I ZBATIMIT 2024-2030	76
7.3	PËRMBLEDHJE E SHPENZIMEVE TË ZBATIMIT	81

Akronimet

NPK	Nënproduktet e kafshëve
UA	Udhëzimi Administrativ
AKM	Asociacioni i Komunave të Kosovës
TMM	Teknikat më të mira të mundshme
BRS	Konventat e Bazelit, Roterdamit dhe Stokholmit
QN	Qendër e ndarjes (qendër e lënies për riciklim)
MNRr	Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënitimit
GMP	Gara për Mjedis të Pastër
DMM	Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit
SIM	Sistemi Informativ Mjedisor
AV	Automjetet e vjetruara
PZP	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
BE	Bashkimi Evropian
KEM	Klasifikimi evropian i mbeturinave
KEM	Klasifikimi evropian i mbeturinave
IGHU	Indeksi Global i Humbjes së Ushqimit
GS	Gazrat serrë
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
MKSh	Mbeturinat e kujdesit shëndetësor
MRr	Mbeturinat e rrezikshme
IMMRr	Inventari i materialeve të mbeturinave të rrezikshme
MIMO	Menaxhimi i integruar i mbeturinave organike
SRJF	Spektori i riciklimit joformal
MIMN	Menaxhimi i integruar i mbeturinave të ngurta
SIMM	Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave
JICA	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KEK	Ndërmarrja Energjetike e Kosovës
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
KFVA	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës
SIMM	Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
LM	Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina
MEF	Faktorët makromjedisorë
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinor dhe Infrastruktura
MF	Ministria e Financave
MSh	Ministria e Shëndetësisë
MPL	Ministria e Pushtetit Lokal
MNK-të	Mbeturinat e ngurta komunale
KaSh	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
O & M	Operimi dhe mirëmbajtja
ShSP	Shëndeti dhe siguria në punë
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPS	Zyra e Planifikimit Strategjik
PAMKOS	Shoqata e Mjedisit më të Pastër për Kosovën
PESTEL	Politikë, Ekonomikë, Socialë, Teknologjikë, Mjedisorë, Ligjorë
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinave
OZhq-të	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA)
LVPP	Lista e Vetme e Projekteve Prioritare
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

WABI	Indikatorët e Standardit “Wasteaware” për MIMN-në
KIBP	Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor
MPEE	Mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike
PMM	Plani për Menaxhimin e Mbeturinave

Përkufizimet

Plani i veprimit	Një dokument tek i cili arrihet përmes një procesi strategjik dhe taktik të vendimmarrjes, i cili i obligon autoritetet kompetente dhe/ose aktorët e tjerë që të zbatojnë masa të caktuara të nevojshme për arritjen e një qëllimi të përcaktuar.
Mbeturinat biologjike	Mbeturinat e biodegradueshme të kopshteve dhe parqeve, mbeturinat e ushqimit dhe të kuzhinës nga amvisëritë, restorantet, furnizuesit e ushqimit dhe lokalet afariste të shitjes me pakicë dhe mbeturinat e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimit.
Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënit	Mbeturinat e prodhuara nga ndërtimi ose rrënimi i ndërtesave dhe infrastrukturës tjetër, në të cilat zakonisht hyjnë toka, betoni, tullat, qelqi, druri, pllakat izoluese, asbesti, metale dhe plastika.
Deponimi	Çdo operacion që nuk është ripërtëritje, edhe kur ky operacion si pasojë dytësore ka ripërtëritjen e substancave apo energjisë.
Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit	Prodhuesit e produkteve të cilat më pas bëhen mbeturina dhe që kanë përgjegjësi për të caktuar masa për mbledhjen dhe menaxhimin (përfshirë ripërdorimin, riciklimin dhe ripërtëritjen) e mbeturinave të tilla në fazën pas konsumimit.
Mbeturinat elektronike	Pajisjet e vjetruara apo të hedhura që e përdorin energjinë elektrike (të njohura edhe si mbeturina të pajisjeve elektrike dhe elektronike, MPEE)
Mbeturinat e gjelbra	Mbeturinat që përbëhen nga gjetet, bari i prerë, ashklat, degët dhe format e tjera të mbeturinave organike të prodhuara nga peizazhet ose kopshtet, të ndara nga mbeturinat e tjera të ngurta.
Menaxhimi i integruar i mbeturinave të ngurta	Përdorimi i koordinuar i një varg metodash dhe zgjidhjesh për menaxhimin e mbeturinave, secila nga të cilat e ka një rol funksional në një sistem të përgjithshëm të menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe që kombinohen së bashku si një tërësi krejtësisht koherente.
Deponia	Vendet ku mbeturinat izoloohen nga mjedisi dhe degradimi i pastajmë i tyre në vend menaxhohen në kuadër të një procesi të kontrolluar fizik, biologjik dhe kimik derisa të bëhen të sigurta.
Mbeturinat e ngurta komunale	Mbeturinat e prodhuara nga amvisëritë ose personat juridikë të një natyre të ngjashme me mbeturinat e amvisërisë.
Parimi “ndotësi paguan”	Zbatimi i tarifave dhe instrumenteve ekonomike për të siguruar që shpenzimet e menaxhimit të mbeturinave të mbarten nga prodhuesi i mbeturinave ose nga mbajtësit/transportuesit e mbeturinave në emër të tyre.
Përgatitja për ripërdorim	Operacionet e kontrollimit, pastrimit ose riparimit e ripërtëritjes, me anë të të cilave përgatiten produktet ose përbërësit e produkteve që janë bërë mbeturina në mënyrë që të mund të ripërdoren pa ndonjë përpunim tjetër paraprak.
Parandalimi	Masat që merren para se një substancë, material apo produkt të jetë bërë mbeturinë dhe që e zvogëlojnë: sasinë e mbeturinave dhe ndikimet negative të mbeturinave të prodhuara në mjedis dhe në shëndetin e njeriut; ose përmbajtjen e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.

Ripërtëritja	Çdo veprim rezultat kryesor i të cilit janë mbeturinat që i shërbejnë një qëllimi të dobishëm duke i zëvendësuar materialet e tjera të cilat përndryshe do të ishin përdorur për ta përmbushur një funksion të veçantë funksion; ose mbeturinat që përgatiten për ta përmbushur atë funksion. Përfshin përdorimin e mbeturinave si zëvendësim për materialet e papërdorura.
Riciklimi	Çdo veprim i ripërtëritjes me të cilin materialet e mbeturinave ripërpunohen në produkte, materiale ose substanca qoftë për qëllimin origjinal, qoftë për qëllime të tjera. Ai përfshin ripërpunimin e materialit organik, por nuk përfshin ripërtëritjen e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që do të përdoren si lëndë djegëse ose për operacione të rimbushjes.
Ripërdorimi	Çdo veprim me të cilin produktet apo komponentët që nuk janë mbeturina përdoren përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin janë konceptuar.
Standardi	Një masë e pranuar e krahasimit të vlerës sasiore ose cilësore; një kriter me të cilin zbatohet dhe/krahasohet performanca e sistemeve të MMN-së.
Transfer stacioni	Një vend ndërtimi apo përpunimi për deponimin e përkohshëm të mbeturinave ku automjetet për mbledhjen e mbeturinave komunale i deponojnë mbeturinat e tyre për t'i ngarkuar në automjete më të mëdha dhe për transportim të mëtejshëm deri në pikën përfundimtare për riciklim, trajtim ose deponim.
Trajtimi	Trajtimi Një metodë, teknikë apo proces që: a) a) E ndryshon karakterin fizik, biologjik apo kimik apo përbërjen e një mbeturine b) b) E heq, ndan, përqendron apo ripërtërin një përbërës të rrezikshëm të mbeturinave c) c) E shkatërron apo e redukton toksicitetin e një mbeturine
Mbeturinat	Çdo substancë, pavarësisht se a ka potencial për t'u reduktuar, ripërdorur, ricikluar ose ripërtërirë; që është tepërisht për nevojat e pronarit/prodhuesit dhe që hidhet.

Përmbledhje ekzekutive

Ligji për Mbeturinat i transponon rregullat evropiane për menaxhimin e mbeturinave dhe e siguron një kornizë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave. Ai i jep përkufizimet, parimet, fushëveprimin, kuadrin e planifikimit strategjik, përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm dhe kërkesat për secilën fazë në zinxhirin e menaxhimit të mbeturinave për llojet e ndryshme të mbeturinave. Ligji e udhëzon përgatitjen e kësaj Strategjie për Menaxhimin e Mbeturinave. Strategjia ekzistuese u miratua në vitin 2013, ndërsa është kërkesë ligjore që ajo të azhurnohet çdo 5 vjet.

Përmes zbatimit të masave që parashikohen në këtë strategji do të trajtohen obligimet e Kosovës që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA-ja) dhe politikat sektoriale në fushën e menaxhimit të mbeturinave të përafërta me ato të BE-së, duke e përshpejtuar kështu procesin e integritimit evropian.

Përveç kësaj, Agjenda e Reformave Evropiane (ARE-ja) është hartuar për t'i maksimizuar dobitë ekonomike dhe politike të MSA-së. Shtylla II - Aftësia konkurruese dhe investimet – e thekson përmirësimin e mëtejshëm të politikave dhe zbatimin e tyre në fushën e mjedisit, duke u përqendruar veçanërisht në menaxhimin e mbeturinave, parimin “ndotësi paguan” dhe përgjegjësinë mjedisore.

Kjo strategji e paraqet qasjen e qeverisë ndaj menaxhimit të integruar të mbeturinave të ngurta (MIMN-së) në Kosovë. Ajo paraqet hapin e ardhshëm drejt realizimit të këtyre prioriteteve strategjike kombëtare. Strategjia i përcakton objektivat strategjike, objektivat specifike, caqet dhe indikatorët për sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. Strategjia mbulon një periudhë dhjetëvjeçare nga viti 2021 deri në vitin 2030 dhe e përfshin një Plan të Veprimit trevjeçar nga viti 2020 deri në vitin 2023.

Vizioni i kësaj strategjie është:

Të mbrohet shëndeti publik dhe të zvogëlohet ndikimi i mbeturinave në mjedis, në të njëjtën kohë gjersa shtohen mundësitë për biznes dhe punësim dhe tranzicion drejt një ekonomie qarkore të harmonizuar me normat dhe standardet evropiane.

Strategjia synon t'i trajtojë të metat dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i përcaktuar dhe realizuar katër objektivat strategjike në vijim. Realizimi i këtyre objektivave strategjike do të luajë rol në shtyrjen e Kosovës përpara drejt potencialeve ekonomike dhe standardeve të jetesës.

Objektivat strategjike dhe specifike për këtë Strategji të Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave janë përcaktuar përmes një analize të problemeve dhe shkaqeve të tyre.

Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i një gjenerate të re të shërbimeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbeturinave. Ky objektivi strategjik do të realizohet me ndihmën e tri objektivave specifike në vijim:

- **Objektivi specifik 1.1:** Sigurimi i shërbimeve të rregullta dhe të besueshme të mbledhjes së mbeturinave të ngurta komunale për tërë popullatën.
- **Objektivi specifik 1.2:** Zhvillimi i rrjetit të qendrave të menaxhimit të integruar të mbeturinave

- **Objektivi specifik 1.3:** Zhvillimi i sistemeve dhe infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave jokomunale.

Shërbimet e Menaxhimit Integruar të Mbeturinave të ngurta Komunale (MIMK-ve) fillojnë me mbledhjen/mbledhjen e ndarë të mbeturinave nga familjet, bizneset dhe institucionet. Mbulimi me shërbime të mbledhjes së mbeturinave është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit, por shërbimet ende nuk ofrohen në mënyrë universale. Kjo Strategji i inkurajon dhe nxit komunat që t'i vazhdojnë përpjekjet e tyre për t'i ofruar shërbime të menaxhimit të mbeturinave tërë popullatës, qoftë drejtpërsëdrejti vetë, nëpërmjet kompanive rajonale të mbeturinave (KRM-ve) apo nëpërmjet sektorit privat.

Në strategji është përfshirë një avancim gjithëpërfshirës i infrastrukturës së transferimit dhe deponimit të mbeturinave komunale. Këto qendra e përbëjnë shtyllën e sistemit të menaxhimit të integruar të mbeturinave. Për këtë program të infrastrukturës është programuar mbështetje e konsiderueshme nga BE-ja dhe partnerët ndërkombëtarë për zhvillim. Pritet që investimi i granteve të rrjedhë natyrshëm drejt atyre qendrave dhe shërbimeve që veprojnë në nivel rajonal/ndërkomunal.

Kjo Strategji përfshin zhvillimin e shërbimeve dhe infrastrukturës për mbeturinat e tjera (jokomunale). Prioritet është zhvillimi i sistemeve të menaxhimit të ndarë për ato lloje të mbeturinave që i kontaminojnë rregullisht mbeturinat komunale, duke përfshirë mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimin, mbeturinat e nënprodukteve të kafshëve dhe mbeturinat e kujdesit shëndetësor.

Objektivi strategjik 2: Profesionalizimi i sektorit të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. Ky objektivi strategjik do të realizohet me ndihmën e tri objektivave specifike në vijim:

- **Objektivi specifik 2.1:** Vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve profesionale në sektorin publik dhe privat.
- **Objektivi specifik 2.2:** Krijimi i një kodi industrial për sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave në statistikat kombëtare.
- **Objektivi specifik 2.3:** Promovimi i kërkimit dhe zhvillimit në universitete.

Mbrojtja e shëndetit publik dhe mjedisit mund të sigurohet vetëm nëse industria e menaxhimit të mbeturinave u përmbahet standardeve profesionale. Industria kosovare e menaxhimit të mbeturinave përbëhet nga një kuadër divers i profesionistëve me përvojë në lëmenj profesionalë të ndryshëm. Gjatë viteve të fundit, organet komunale dhe të industrisë si AKK-ja dhe PAMKOS kanë qenë dinamike në përmirësimin e standardeve profesionale.

Duke shkuar përpara, vëmendja do të përqendrohet në ndihmën që do t'u ofrohet komunave për t'i konsoliduar shërbimet e tyre të menaxhimit të mbeturinave dhe sistemet e financimit publik, duke e forcuar njëkohësisht kapacitetin e tyre për ta menaxhuar rrjetin e qendrave të menaxhimit të integruar të mbeturinave. Krahas kësaj, industria e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave do të njihet zyrtarisht si industri përmes caktimit të një kodi statistikor për industri.

Potenciali i të rinjve për karrierë në të ardhmen varet nga cilësia e arsimit. Përderisa BE-ja po lëviz në një ritëm drejt një ekonomie qarkore, është jetike që të përgatitet një gjeneratë e re e profesionistëve për të hyrë në industrinë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. Universitetet do ta luajnë një rol kyç në këtë proces.

Objektivi strategjik 3: Forcimi i rregullimit dhe kontrollit në sektorin e menaxhimit të mbeturinave duke i plotësuar boshllëqet dhe duke i qartësuar mekanizmat e zbatimit. Ky objektivi strategjik do të realizohet me ndihmën e tri objektivave specifike në vijim:

- **Objektivi specifik 3.1:** Krijimi i një sistemi informativ gjithëpërfshirës dhe funksional për menaxhimin e mbeturinave.
- **Objektivi specifik 3.2:** Zgjerimi i sistemit të dhënies së licencave dhe lejeve për menaxhimin e mbeturinave për t'i mbuluar të gjitha mbeturinat, operatorët dhe qendrat e menaxhimit të mbeturinave.
- **Objektivi specifik 3.3:** Forcimi i mekanizmave zbatues, përfshirë komunitat dhe inspektoratet.

Gjithmonë do të jetë një pjesë e popullatës që do të jetë rezistente ndaj ndryshimit dhe e cila nuk do ta respektojë ose ndiejë rëndësinë dhe dobinë e një mjedisi të pastër. Do të përcaktohen procedurat më efektive të rregullimit dhe kontrollit si dhe mekanizmat e zbatimit që do të mbështeten nga sistemet e dhënies së licencave dhe lejeve.

Sistemet e menaxhimit përfitojnë nga të dhënat dhe sistemet e menaxhimit të mbeturinave nuk përbëjnë përjashtim. Sistemet ekzistuese të menaxhimit të të dhënave do të forcohen për të ofruar informata në kohë për vendimmarrje për rregullim, kontroll dhe menaxhim të përditshëm.

Objektivi strategjik 4: Promovimi i vlerave dhe praktikave të një ekonomie qarkore. Ky objektivi strategjik do të realizohet me ndihmën e tri objektivave specifike në vijim:

- **Objektivi specifik 4.1:** Ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.
- **Objektivi specifik 4.2:** Stimulimi i inovacioneve në parandalimin e mbeturinave.
- **Objektivi specifik 4.3:** Krijimi i sistemeve të ripërdorimit dhe riciklimit bazuar në konceptin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Me kalimin e kohës, shërbimet e menaxhimit të mbeturinave do të bëhen më komplekse, me krijimin gradual të sistemeve të mbledhjes me kontejnerë të shumtë dhe me publik, biznese dhe institucione nga të cilat do të kërkohet që të bashkëveprojnë me shërbimet e menaxhimit të mbeturinave në mënyra të ndryshme. Një ndryshim kulturor i qëndrimeve dhe sjelljes është i nevojshëm për ta mbështetur këtë tranzicion.

BE-ja e ka përcaktuar një politikë ambicioze për të lëvizur në drejtim të ekonomisë qarkore. Energjia e këtij procesi po shtyn përpara horizontet dhe potenciale ekonomike të reja. Është vendosur që format evropiane të prodhimit dhe konsumit të ndryshojnë ndjeshëm në dekadat e ardhshme dhe Kosova do t'i përshtatet dhe përgjigjet kësaj sfide.

Kjo strategji do të nxisë përmirësime të mëdha në sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. Është hartuar një Plan i Veprimit që e mbulon periudhën 2021-2023 dhe që përmban dispozita për dokumentet e planifikimit strategjik në nivel qendror. Plani i parë i veprimit ka të bëjë me fillimin e procesit strategjik dhe krijimin e rrjetit të avancuar të qendrave të menaxhimit të mbeturinave. Financimi i programuar për zbatimin e Strategjisë është si vijon: Periudha e dytë ka të bëjë me konsolidimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të dobive për ekonominë.

Shpenzimet e zbatimit	2021-2023	2024-2030	Gjithsej
Objektivi strategjik 1: Shërbimet dhe infrastruktura	45.128.892	18.405.000	63.533.892
Objektivi strategjik 2: Profesionalizimi i sektorit të mbeturinave dhe riciklimit	1.129.000	0	1.129.000
Objektivi strategjik 3: Rregullimi dhe kontrolli	8.972.250	4.125.000	13.097.250

Shpenzimet e zbatimit	2021-2023	2024-2030	Gjithsej
Objektivi strategjik 4: Ekonomia qarkore	3.053.737	24.332.785	27.386.523
Gjithsej (në euro)	58.283.879	46.862.785	105.146.665

Disa nga indikatorët e OZhQ-ve ndërlidhen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me sektorin e mbeturinave, ndërsa në veçanti katër indikatorët në vijim janë synuar në mënyrë të veçantë në këtë Strategji; 11.6.1 për mbeturinat e ngurta komunale, 12.3.1 për mbeturinat e ushqimit, 12.4.2 për mbeturinat e rrezikshme dhe 12.5.1 për shkallën e riciklimit. Indikatorët strategjikë dhe specifikë të përfshirë në këtë Strategji synojnë drejtpërsëdrejti realizimin e OZhQ-ve.

1. Hyrje

Mbeturinat janë nënprodukt nga jeta e jonë e përditshme personale dhe profesionale, që krijohen nga shtëpitë tona, bizneset, industria, vendet e ndërtimit, spitalet dhe zyrat qeveritare. Gjërat që i hedhim duhet të ruhen, mbledhen, transportohen, përpunohen, riciklohen, trajtohen dhe deponohen në mënyrë të sigurt.

Për t'i adresuar mangësitë ekzistuese dhe për ta ndërtuar një sistem më të fuqishëm dhe më të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave, ne duhet ta përdorim një kombinim të qasjeve në një mënyrë të koordinuar dhe koherente. Shërbimet rezultuese të menaxhimit të integruar të mbeturinave të ngurta (MIMN-së) na sjellin qytete, qyteza dhe fshatra të pastra, kontrolle të mira të mbrojtjes së mjedisit dhe një ndjenjë të përgjegjësisë kolektive në komunitet.

Përderisa pjesa e parë e zinxhirit të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave – mbledhja e mbeturinave - është e dukshme për syrin e publikut, MIMN mbështetet në trajtimin dhe përpunimin kompleks të materialeve të rrjedhës së poshtme që zakonisht nuk kuptohen apo çmohen mirë

Ndërsa ekonomia zhvillohet, një shumëllojshmëri më e madhe e produkteve vjen nëpërmjet fabrikave, zyrave, dyqaneve dhe supermarketeve tona. Produktet e konsumit po bëhen më të sofistikuara dhe më komplekse sa i përket përmbajtjes materiale të tyre. Në disa raste ato përmbajnë materiale të vlefshme, por në shumë të tjera mbeturinat që i hedhim kanë pak vlerë, nuk kanë vlerë fare ose kanë vlerë negative. Kjo ndodh sidomos kur materialet përzihen.

Ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave të ngurta komunale është përgjegjësi primare dhe funksioni themelor i komunave. Komunat dhe kompanitë e tyre rajonale të mbeturinave (KRM-të) janë ofruese të shërbimeve të vijës së parë të frontit në këtë drejtim. Ka dhe do të mbetet rol për financimin publik të sistemeve të menaxhimit të mbeturinave, ndërsa ata që prodhojnë mbeturina duhet t'i kontribuojnë mbulimit të këtyre shpenzimeve.

Gjatë disa viteve të fundit është bërë përparim i mirë në përmirësimin e mbulimit me shërbime dhe cilësisë së shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave. Nga një bazë prej rreth 57% të mbulimit me shërbime të mbledhjes së mbeturinave në vitin 2015, shërbimet e mbledhjes së mbeturinave janë shtrirë në 69% të popullsisë në vitin 2018 (AMMK reports) dhe kjo përqindje po rritet çdo muaj. Kjo do të thotë se jemi në rrugën tonë drejt ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse të mbledhjes së mbeturinave për tërë popullatën, por se ende ka ca punë për t'u bërë për ta arritur këtë qëllim.

Rëndësi më të madhe gjatë viteve të fundit i është kushtuar reformimit të sektorit të menaxhimit të mbeturinave. Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave është përfshirë si kapitull në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, duke u përqendruar në nevojën për të investuar në infrastrukturën e menaxhimit, për t'i konsoliduar kompanitë publike, për t'i kontraktuar operatorët ekonomikë, për ta ngritur vetëdijësimin dhe për ta stimuluar riciklimin.

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA), e cila hyri në fuqi më 1 prill 2016, e obligoi Kosovën (neni 115 i Ligjit për Mjedisin) që t'i përmbushë obligimet lidhur me ndalimin e degradimit të mëtejshëm të mjedisit dhe fillimin e përmirësimit të kushteve mjedisore. Si pasojë, përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është paraparë në programin kryesor për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA), respektivisht në indikatorin (pika 3.28) "Miratimi i Strategjisë 2021-2030 dhe Planit të Veprimit 2021-2023 për Menaxhimin e Mbeturinave".

Përmes zbatimit të masave që parashikohen në këtë strategji do të trajtohen obligimet e Kosovës që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA-ja) dhe politikat sektoriale në fushën e menaxhimit të mbeturinave të përafërta me ato të BE-së, duke e përshpejtuar kështu procesin e integritimit evropian.

Përveç kësaj, Agjenda e Reformave Evropiane (ARE-ja) është hartuar për t'i maksimizuar dobitë ekonomike dhe politike të MSA-së. Shtylla II - Aftësia konkurruese dhe investimet – e thekson përmirësimin e mëtejshëm të politikave dhe zbatimin e tyre në fushën e mjedisit, duke u përqendruar veçanërisht në menaxhimin e mbeturinave, parimin “ndotësi paguan” dhe përgjegjësinë mjedisore.

Ligji për Mbeturinat¹ i transponon rregullat evropiane për menaxhimin e mbeturinave dhe e siguron një kornizë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave. Ai i jep përkufizimet, parimet, fushëveprimin, kuadrin e planifikimit strategjik, përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm dhe kërkesat për secilën fazë në zinxhirin e menaxhimit të mbeturinave për llojet e ndryshme të mbeturinave. Ligji e udhëzon përgatitjen e kësaj Strategjie për Menaxhimin e Mbeturinave. Strategjia ekzistuese u miratua në vitin 2013, ndërsa është kërkesë ligjore që ajo të azhurnohet çdo 5 vjet.

Kjo strategji e paraqet qasjen e qeverisë ndaj MIMN-së në Kosovë. Ajo paraqet hapin e ardhshëm drejt realizimit të këtyre prioriteteve strategjike kombëtare. Strategjia i përcakton objektivat strategjike, objektivat specifike, caqet dhe indikatorët për sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. Strategjia mbulon një periudhë dhjetëvjeçare nga viti 2021 deri në vitin 2030 dhe e përfshin një Plan të Veprimit trevjeçar nga viti 2021 deri në vitin 2023.

2. Metodologjia

Këtë Strategji të Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave (SIMM) 2021-2030 e ka përgatitur Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, në bashkëpunim me ministritë, autoritetet kompetente dhe akterët e kësaj industrie:

- Zyra e Kryeministrit
- Ministria e Financave dhe punes
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Pushtetit Lokal
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
- Shoqata për Mjedis të Pastër të Kosovës
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës
- Agjencia e Metrologjisë e Kosovës
- Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
- Ndërmarrja Energjetike e Kosovës

Sipas Ligjit për Mbeturina, ajo i trajton të gjitha fraksionet e mbeturinave, duke përfshirë: mbeturinat komunale, mbeturinat e ndërtimit dhe rrënit, mbeturinat bujqësore dhe të kafshëve, mbeturinat e kujdesit shëndetësor, mbeturinat industriale dhe minerare, mbeturinat e rrezikshme


¹ Ligji Nr. 04/L-060

dhe të kujdesit shëndetësor dhe llojet e fraksionet e tjera specifike të mbeturinave, siç janë ambalazhi, tekstili, automjetet, gomat, pajisjet elektrike dhe elektronike, vajrat, bateritë dhe llumi.

Kjo Strategji është përgatitur sipas kërkesave lidhur me procesin dhe procedurat e hartimit të dokumenteve strategjike që i përmban Udhëzimi Administrativ (UI) për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit². Faqosja dhe përmbajtja e kësaj Strategjie dhe e Planit të Veprimit shoqërues u përmbahen kërkesave që janë përcaktuar në UA

Përgatitja e Strategjisë është mbikëqyrur nga një grup punues ndërministror, i cili është kryesuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke përfshirë përfaqësuesit e institucioneve të renditura më lart. Asistenca teknike për përgatitjen e dokumentit strategjik dhe lehtësimi i procesit të konsultimit është siguruar nga Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim, që është realizuar nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ-i).

Për metodologjinë e përgatitjes së kësaj Strategjie janë ndjekur praktikat më të mira ndërkombëtare. Procesi ka filluar në prill të vitit 2018 me një seminar fillestar. Janë mbajtur një varg seminararesh, të cilat janë përqendruar në kornizën strategjike, analizën e opsioneve si dhe diskutimin dhe finalizimin e draftit të strategjisë. Kërkesat që janë përcaktuar në Rregulloren për Standardet Minimale të Konsultimit Publik³ janë respektuar.



Qëllimi kryesor i Strategjisë është që të sigurohet që ajo të jetë:

Kuptimplotë në aspektin e sjelljes së një ndryshimi me ndikim.

Realiste dhe e zbatueshme në kontekstin e sektorit specifik në Kosovë.

Në përputhje me standardet dhe kërkesat kombëtare dhe evropiane.

Caqet dhe indikatorët janë përcaktuar për të qenë të arritshme, në kuadër të burimeve financiare që dihet se janë në dispozicion, të plotësuar me financat që janë zotuar nga partnerët zhvillimorë ndërkombëtarë.

Për realizimin e caqeve dhe indikatorëve do të kërkohet një përpjekje e vendosur dhe e koordinuar nga qeveria, komunat dhe industria e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave, e mbështetur nga programet për ndërtim të kapaciteteve dhe financim për zhvillim.

² Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2018


³ Rregullorja Nr. 05/2016

3. Historiku


3.1 Prodhimi i mbeturinave

Shumica e raporteve bazë përqendrohen në mbeturinat e ngurta komunale (MNK-të). Të dhëna për MNK-të ka dhe, megjithëse ende nuk janë gjithëpërfshirëse, mjaftojnë për t'i përcaktuar bazat dhe caqet. Statistikat më të fundit zyrtare për sasi të **mbeturinave të ngurta komunale** janë nga viti 2017. Statistikat bazë për krahasim janë paraqitur më poshtë:

- Vlerësohet se prodhohen 580,000 tonë MNK.
- Vlerësohet se menaxhohen (mblidhen dhe deponohen) 420,000 tonë (74% e gjithsej MNK-ve).
- Vlerësohet se 290,000 tonë (50% e gjithsej MNK-ve) janë mbeturina komunale të biodegradueshme.
- Vlerësohet se 90,000 tonë (15% e gjithsej MNK-ve) janë mbeturina të ambalazhit (letër, plastikë, qelq, metal).



Fraksionet e tjera të mbeturinave, në veçanti burimet dhe llojet e ndryshme të mbeturinave industriale, nuk janë studiuar plotësisht dhe, rrjedhimisht, të dhënat mungojnë shumë. Dihet pak për natyrën dhe sasi të mbeturinave komunale të tjera jokomunale (p.sh. nga industria, minierat etj.) që prodhohen në tërë Kosovën.



Në statistikat zyrtare që i janë raportuar Eurostat-it është raportuar se në Kosovë prodhohen gjithsej 1 milion tonë **mbeturina**⁴.

Ka pasur disa zbrazëtira në këto të dhëna, duke përfshirë mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimin si dhe mbeturinat nga termocentralet. Pas një pune në azhurnimin e të dhënave që është bërë gjatë përgatitjes së kësaj Strategjie, një vlerësim i rishikuar


sugjeron se sasia totale e mbeturinave të prodhuara është 1.4 milion ton⁵.

Proporcionet e prodhuara nga të katër burimet kryesore të mbeturinave janë ilustruar në tabelën e në vijim në formë të tortës.

⁴Eurostat, të dhënat për vitin 2014

⁵Përfshin (a) vlerësimet e përditësuara të mbeturinave të ngurta komunale, (b) vlerësimet e azhurnuara të AMMK-së kur janë në dispozicion dhe (c) shifrat referente nga vendet e tjera përkatëse ku nuk ka të dhëna lokale.


Gjithsej mbeturinat e prodhuara sipas aktiviteteve ekonomike dhe amvisërive (SKMIMN, 2017)



Me përjashtim të mbeturinave komunale, këto janë vlerësime të përafërta që ende nuk janë nxjerrë nga sisteme të fuqishme të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave. Vlerësimet do të azhurnohen në shqyrtimet e mëtejshme të Strategjisë, posa të ketë tërësi të të dhënave të përmirësuara. Në nënkuptinat e mëposhtme është ofruar një përmbledhje e shkurtër e çështjeve kryesore që mjafton për t'i identifikuar mangësitë dhe për të shërbyer si udhëzim për formulimin e objektivave strategjike.

3.2 Faktorët makromjedisorë

Menaxhimi i integruar i mbeturinave të ngurta është temë komplekse dhe disiplinë profesionale e specializuar. Për t'i kuptuar çështjet që i japin trajtë situatës së menaxhimit të mbeturinave, ne duhet të shqyrtojmë Faktorët Makromjedisorë (FMM-të) duke e përdorur analizën PESTEL.



3.2.1 Faktorët politik

Konteksti politik për reformimin e sistemeve dhe shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave po merr trajtë nga vizioni i standardit evropian të jetesës, potencialet ekonomike dhe afariste dhe integrimi shoqëror.

Kosova dëshiron t'i bashkohet Bashkimit Evropian dhe për ta bërë këtë duhet të tregojë vendosmëri dhe përparim drejt përafrimit të normave dhe standardeve mjedisore me shtetet anëtare të BE-së.

3.2.2 Faktorët ekonomikë

Faktorët ekonomikë diktojnë standardin e jetesës dhe mundësitë potenciale për biznes dhe punësim. Si sektor i ekonomisë, menaxhimi dhe riciklimi i mbeturinave nuk është edhe aq i zhvilluar në Kosovë.

Potencialet e reja ekonomike po hapen me një ritëm të shpejtë gjithkrah dhe Kosova dëshiron të jetë pjesë e tranzicionit ekonomik të vazhdueshëm të Evropës drejt një ekonomie qarkore dhe të përfitojë nga ajo. Për ta arritur këtë, kërkohen investime të konsiderueshme për ta avancuar infrastrukturën dhe shërbimet e menaxhimit të mbeturinave. Kostoja e sistemeve të zhvilluara duhet të jetë e përshtatshme dhe përputhshme me mjetet financiare lokale, ndërsa mbështetja përmes granteve është qenësore për ta arritur këtë.

3.2.3 Faktorët social

Kosova është shoqëri në zhvillim e bazuar në treg, me njerëz shumë pragmatikë dhe punëtorë të mëdhenj. Kosovarët krenohen me aftësinë e tyre për të mbijetuar dhe përparuar përballë vështirësive, ndërsa pavarësinë dhe lirinë e zgjedhjes i konsiderojnë si parime të rendit më të lartë.

Çfarë është e përbashkët për shumicën e shoqërive ballkanike, shkalla e të kuptuarit dhe vlerësimit publik për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave është mjaft e ulët. Njerëzit nuk janë të prirë të shqetësohen se ku shkojnë mbeturinat që ata i hedhin dhe se çfarë ndikimi mund të kenë sistemet e menaxhimit të rrjedhës së ulët në shëndetin publik dhe në mjedis.

Vetëdija për lidhjet e veçanta shkak-pasojë midis vendimeve për blerje dhe sasive të mbeturinave është po ashtu shumë e ulët. Megjithatë, si një shoqëri në zhvillim në aspektin ekonomik, në të cilën shkalla e varfërisë është mjaft e lartë, vendimet e njerëzve për të blerë ndikohen mjaft nga ndryshimet sado të vogla në çmim.

Spektori joformal i riciklimit (SJFR) luan rol të rëndësishëm në Kosovë. Ky sektor kryesisht përbëhet nga shtresa me gjendje sociale më të rënduar, duke përfshirë të gjitha komunitetet, shërbimi i të cilëve kontribuon në reduktimin e sasive të mbeturinave për të cilat kërkohet mbledhja dhe deponimi nga sektori formal.

3.2.4 Faktorët teknologjikë

Rrjeti i parë gjenerues i qendrave të menaxhimit të mbeturinave dhe marrëveshjeve për shërbime është krijuar gjatë rindërtimit pas konfliktit. Duke iu përgjigjur nevojave urgjente, infrastruktura është krijuar në një model të përshtetshëm nga lart-poshtë. Gjatë kësaj periudhe, ndërmarrjet publike janë krijuar si model i operatorit primar për ofrimin e shërbimeve.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale fillimisht e ka nxitur decentralizimin e menaxhimit të mbeturinave, ndërsa, rrjedhimisht, me Ligjin për Mbeturina, përgjegjësitë e menaxhimit për planifikim si dhe për menaxhim dhe përdorim të sistemeve të menaxhimit të mbeturinave janë decentralizuar tek komunat. Përderisa komunat i kanë marrë relativisht përgjegjësitë dhe funksionet kryesore për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave vetëm kohëve të fundit, tashmë po dëshmojnë rezultate të mira sa i përket mbulimit me shërbime dhe përmirësimit të cilësisë së tyre.

3.2.5 Faktorët mjedisorë

Qëllimi kryesor i sistemeve të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave është mbrojtja e mjedisit nga efekti i dëmshëm i aktivitetit njerëzor. Përpjekjet që janë bërë viteve të fundit për t'i avancuar sistemet e menaxhimit të mbeturinave e dëshmojnë synimin e Kosovës për të lëvizur përpara në këtë sektor të mbrojtjes së mjedisit. Puna e vazhdueshme mbështetet në një rregullim dhe kontroll të fuqishëm, të shoqëruar me investime në infrastrukturë, edukim dhe ngritje të vetëdijes.

3.2.6 Faktorët ligjorë

Korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave është mirë e zhvilluar në Kosovë. Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat (LP) është gjithëpërfshirës sa i përket mbulimit të kërkesave brenda të cilave duhet të veprojë sektori i mbeturinave. Disa rregullore janë miratuar dhe janë në fuqi, por mungon zbatim i kërkesave rregullative. Zbatimin e pengojnë resurset e pamjaftueshme për monitorim dhe kontroll dhe mungesa e mekanizmave të mirëfilltë të stimulimit dhe gjobitjes së prodhuesve të mbeturinave.

3.3 Gjendja ekzistuese

3.3.1 Mbeturinat e ngurta komunale


Problemet në sektorin e mbeturinave të ngurta komunale janë kuptuar gjerësisht dhe janë paraqitur në disa raporte dhe publikime gjatë viteve të fundit. Këto përfshijnë Raportin për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale në Kosovë, Raportin për Gjendjen e Mjedisit (2018), Raportin për Gjendjen e Mbeturinave dhe Kimikateve (2014) dhe Raportin për Hotspotet Mjedisore (2011) të publikuara nga AMMK-ja.

Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave aktualisht është rreth 74% dhe po ngritet gradualisht. Në hartën e mëposhtme është paraqitur gjendja e shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave të ngurta komunale sipas të dhënave të vitit 2017.


Kosova është rrezikshmërisht afër shterjes së kapacitetit të lluar të deponive të saj. Përveç kësaj, deponitë ekzistuese nuk menaxhohen në përputhje të plotë me kërkesat e Direktivës për Deponitë të BE-së. Një gjeneratë e dytë e qendrave të menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë përmirësimin dhe zgjerimin e qendrave dhe shërbimeve ekzistuese, është prioritet urgjent. Ky përmirësim i infrastrukturës duhet të mbështetet me vënien në zbatim të sistemeve të përmirësuara të mbledhjes të mbeturinave, duke përfshirë sisteme të veçanta të mbledhjes dhe menaxhimit për lloje të ndryshme të mbeturinave/materialeve.

Një program i investimit është formuluar dhe përfshirë në Listën e Vetme të Projekteve Prioritare,

	Lista e vetme e projekteve prioritare	Buxheti i parashikuar
1	Ndërtimi i transfer stacionit dhe qendrës për ndarjene mbeturinave në (Klinë, Istog, Skenderaj, Novobërdë)	2 010 000
2	Ndërtimi i transfer stacionit dhe qendrës për ndarjen e mbeturinave në Ferizaj	5 255 292
3	Ndërtimi i qendrës për ndarjene mbeturinave dhe qendrës për kompostim në Prizren	5 254 000
4	Ndërtimi i qendrës për ndarjene mbeturinave në Pejë	3 495 708
5	Ndërtimi i qendrave për magazinimin e mbeturinave të rrezikshme	12 000 000
6	Përmirësimi i gjendjes teknike dhe operative në deponinë e rajonit të Prishtinës në Mirash - Obiliq	3 220 000
7	Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë ekzistuese në Pejë	3 850 000
8	Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë ekzistuese në Dragash	2 295 600
9	Ndërtimi i qendrave për trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimin në komunat e Kosovës	7 900 000



Burimi: AMMK, 2018



Burimi: AMMK, 2018

3.3.2 Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënitit



Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënitit mund të përbëhen nga një larushi materialesh dhe janë në përgjithësi të vëllimshme dhe të rënda. Gjendja aktuale në Kosovë sa u përket mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitit është se, për shkak të zgjerimit të shpejtë të industrisë së ndërtimit, kjo rrjedhë e mbeturinave po rritet me shpejtësi dhe ato po hidhen në mënyrë të paligjshme nëpër toka bujqësore dhe në lumenjtë që gjenden afër tyre. Përveç kësaj mënyre të deponimit, komunat i kanë përdorur parcelat e tokës publike për t'i hedhur MNRr-të, por këto nuk janë të ndërtuara sipas ndonjë standardi të njohur. Përveç 170,000

tonëve të MNRr-ve që vlerësohet se prodhohen, është vlerësuar se që nga viti 2017 në Kosovë janë 1,572 deponi me ~ 140,000 m³ mbeturina të ndërtimit dhe rrënitit.

Nuk ka më strukturë funksionale në Kosovë për t'i trajtuar mbeturinat e asbestit dhe ky po bëhet problem serioz. Sondazhet në vendet e tjera tregojnë se mbeturinat e rrezikshme (asbesti, plumbi, substancat e tjera të rrezikshme) në MNRr-të mund të përbëjnë deri në 15%. Zakonisht supozohet se asbesti përbën 2.5-5% të vëllimit të përgjithshëm historik të MNRr-ve. Bazuar në vlerësimin e AMMK-së për sasitë e përgjithshme të MNRr-ve, asbesti pritet të jetë në rangun prej 4.000 – 9.000 tonë në vit.

Janë 90 kompani me licencë për mbledhjen e fraksioneve të ndryshme të mbeturinave (pohuajse gjysma e tyre mbledhin mbeturina të ngurta komunale), por asnjëra nga to nuk i menaxhon mbeturinat e ndërtimit dhe rrënitimit.

Kosova ka ligje që kanë të bëjnë me mbeturinat e ndërtimit dhe rrënitimit (MNRr-të), por ka mungesë të zbatimit, pastaj komunat nuk kanë kapacitete dhe financa për të krijuar vende apo për të hartuar rregullore dhe procedura lokale – kjo i bën më të rënda problemet me deponimin ilegal të mbeturinave.

3.3.3 Mbeturinat bujqësore dhe të kafshëve

Mbeturinat bujqësore përkufizohen si mbeturina që krijohen nga prodhimi i ushqimit dhe përfshijnë përdorimin e produkteve që gjatë veprimtarisë bujqësore. Në Kosovë përfshihen edhe mbeturinat e industrisë ushqimore, në të cilat bëjnë pjesë nënproduktet e kafshëve, siç janë eshtrat e thertoreve⁶, bagëtitë e ngordhura, plehu organik, mbeturinat nga prodhimi i bulmetit, mbeturinat nga prodhimi i alkoolit/pijeve alkoolike dhe çdo artikull ushqimor që është prishur apo e ka arritur datën e skadimit.



Vlerësohet se në Kosovë prodhohen dhe deponohen ~ 14,500 tonë mbeturina të kafshëve apo mbeturina të nënprodukteve të kafshëve në vit. Shumica e tyre në deponi deponohen bashkë me mbeturinat e amvisërisë. Disa komunitete dhe disa thertore i kanë zhvilluar mjetet e veta për menaxhimin e mbeturinave të kafshëve, ndonëse procesi i kompostimit dhe menaxhimi i mbeturinave nga kullimi dhe i ujërave të zeza është kryesisht i parregulluar.

Në Kosovë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është përgjegjëse për kornizën legjislative për menaxhimin e mbeturinave të kafshëve, ndërsa Ligji për Mbeturina nuk është preciz në këtë drejtim. Deri më sot nuk është miratuar ndonjë ligj që do ta rregullonte këtë rrjedhë të mbeturinave sipas normave të BE-së.

3.3.4 Automjetet

Kompanitë apo individët që i menaxhojnë automjetet e vjetruara (AV-të) duhet të jetë i licencuar dhe t'u përmbahen ligjeve për vendndodhjen e qendrave të çmontimit. Ata po ashtu duhet të mbajnë evidenca për atë që kanë mbledhur dhe për llojet dhe sasi të substancave të rrezikshme që janë larguar.



Megjithatë, në praktikë, nuk ka sistem formal të mbledhjes, ndërsa sistemi i licencimit nuk po funksionon mirë. Pronarët e mbeturinave të vjetra zakonisht ua shesin ato depove të automjeteve të prishura, të licensuara për këtë aktivitet, ku ato pastaj ose çmontohen për pjesë rezervë, u hiqen pjesët na metali dhe/ose eksportohen në vendet e tjera në rajon.

⁶ Foto nga: PAMKOS, 2018

Nuk ka të dhëna për numrin e AV-ve të trajtuara, apo të dhëna për proporcionin e ripërdorur apo të ricikluar. Me sa duket, e vetmja e dhënë e besueshme sa u përket automjeteve është ajo që është ofruar nga "Agjencia e Statistikave të Kosovës", e cila thotë se numri i automjeteve të regjistruara për vitin 2017 ka qenë 334,440. Aktualisht nuk ka informata për vendin ku dërgohen apo ruhen AV-të apo nëse ato çmontohen dhe ripërdoren/riciklohen, braktisen/u hiqen pjesët e metalit brenda vendit apo eksportohen.

3.3.5 Gomat



Nga personat e përfshirë në menaxhimin e gomave mbeturinë kërkohet që të jenë të licencuar dhe të mbajnë evidenca për vëllimet e trajtuara. Importuesit dhe prodhuesit duhet të mbajnë evidenca për vëllimet që hyjnë në sistem. Komunat kanë për obligim që t'i lejojnë qendrat për servisim, mbledhje dhe trajtim të gomave në territoret e tyre, ndërsa këto qendra duhet të drejtohen nga personeli i licencuar.

Kosova aktualisht i ka tri kompani të licencuara për mbledhjen, rinovimin/trajtimin/riciklimin e gomave. Megjithatë, nuk ka të dhëna për sasinë e gomave që ende janë duke u administruar nga industria. Metodot aktuale për vlerësimin e vëllimit të gomave janë vetëm rudimentare – me shifra të pasakta që nuk mund të merren si bazë e duhur.

Gomat mbeturinë përbëjnë një kërcënim të madh ndaj mjedisit, shëndetit dhe sigurisë, veçanërisht për shkak të rrezikut nga zjarri. Sistemi i menaxhimit të gomave të vjetruara ende nuk është krijuar siç duhet dhe duhet të trajtohet në mënyrë që të jetë në përputhje me kërkesat evropiane.

3.3.6 Pajisjet elektrike dhe elektronike

Nga personat e përfshirë në menaxhimin e mbeturinave të pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE-ve) kërkohet që të jenë të licencuar. Mbajtësit e licencave janë përgjegjës për ndarjen e pajisjeve dhe duhet të mbajnë evidenca përkitazi me prejardhjen/destinacionet/vëllimet e MPEE-ve të trajtuara.



Një udhëzim administrativ është miratuar për ta filluar një skemë të përgjegjësive së zgjeruar të prodhuesit (PZP-së) për MPEE-të, sipas të cilit objektivat e mbledhjes duhet të ngriten gradualisht gjatë viteve të ardhshme, duke e synuar një shkallë të mbledhjes prej 85% deri në vitin 2019.

Kosova aktualisht i ka pesë kompani të licencuara për mbledhjen dhe përpunimin e MPEE-ve. Aktualisht, nuk ekzistojnë skema grumbullimi, qendra apo impiante për çmontim dhe nuk ka të dhëna për llojet dhe sasinë e MPEE-të.

MPEE-të përbëjnë rrjedhë të rëndësishme e mbeturinave që duhet të menaxhohet në mënyrë profesionale. Shumë pajisje elektronike mbeturina përmbajnë materiale të rrezikshme që kërkojnë menaxhim të specializuar. Ato po ashtu përmbajnë rëra të rralla dhe përbërës të tjerë kimikë që janë të rrallë globalisht dhe që kanë vlerë të konsiderueshme. Ripërtëritja e vlerës materiale të çmuar nga MPEE-të nuk duhet vijë në dëm të standardeve mjedisore, të shëndetit dhe sigurisë.

3.3.7 Vajrat



Nga personat e përfshirë në menaxhimin/mbledhjen/trajtimin e vajrave të përdorura kërkohet që të jenë të licencuar dhe të regjistruar dhe janë përgjegjës për mbajtjen e evidencave përkitazi me të gjitha aspektet e menaxhimit të mbeturinat e vajit. Udhëzimi administrativ për mbeturinat e vajit i përcakton rregullat për menaxhimin e vajrave mbeturinë.

Kosova aktualisht i ka katër kompani të licencuara për mbledhjen dhe përpunimin e vajrave të përdorura. Nuk ka asnjë sistem zyrtar të mbledhjes apo trajtimit dhe nuk ka të dhëna në dispozicion për vëllimet e vajrave të përdorura që janë trajtuar. Metodot për vlerësimin e vëllimeve të vajrave të përdorura në Kosovë nuk janë të zhvilluara mirë.

Vajrat e përdorura janë fraksion i rëndësishëm i mbeturinave që menaxhohet në mënyrë profesionale, për shkak të rreziqeve ndaj mjedisit, shëndetit dhe sigurisë. Disa vajra janë të rrezikshme, ndërsa të tjerat përdoren për konsum njerëzor. Duhet të parandalohet hedhja e cilësdo kategori të vajrave nëpër kanalizime apo kanale të lundrueshme; por ato duhet të mbledhen, ripërtërihen ku është e mundur dhe të përdoren si lëndë djegëse apo të deponohen në mënyrë të sigurt atëherë kur ripërdorimi/riciklimi i tyre nuk është i mundur.

3.3.8 Bateritë

Bateritë dhe akumulatorët janë çdo burim i energjisë elektrike të përfitur nga konvertimi i energjisë kimike në energji elektrike. Posa kjo energji konsumohet dhe njësia nuk mund të rimbushet, bateritë bëhen mbeturinë.

Ligjërisht, personat e përfshirë në menaxhimin e këtyre mbeturinave duhet të licencohen dhe janë përgjegjës për mbajtjen e evidencave përkitazi me llojet dhe sasinë e baterive. Ligji për Mbeturina e përcakton kornizën për krijimin e sistemit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (PZP-së) në të cilën nga importuesit, shpërndarësit, shitësit me pakicë dhe komunat kërkohet që të krijojnë skema të ndara të mbledhjes/kthimit, por ky kusht nuk është plotësuar ende në praktikë.



Një kompani është e licencuar për mbledhjen e baterive, ndërsa gjashtë për akumulatorë. Aktualisht nuk ekziston ndonjë sistem etiketimi dhe shënimi apo ndonjë bazë e të dhënave për sasinë e importuara. Nuk ka qendra të mbledhjes, nuk ka mbledhje të ndara në nivel komunal, nuk ka evidencat për sasinë e as instrumente ekonomike në përdorim.

Aktualisht, në Kosovë çdo vit importohen akumulatorë në vlerë prej 5 milionë eurove. Sasinë dhe natyra potencialisht e rrezikshme e këtyre baterive dhe akumulatorëve kërkojnë aranzhime të menaxhimit profesional. Në të ardhmen, kur automjetet elektrike të përforcohen, nevoja për një sistem të përforcuar për trajtimin dhe menaxhimin e baterive mbeturinë do të shtohet.

3.3.9 Llumi



Llumi është nënprodukt i trajtimit të ujit me prejardhje urbane dhe familjare, balta nga gropat septike dhe lënda e ngurtë nga qendrat e trajtimit të ujërave të zeza (QTUZ-të). Ligji për Mbeturina i përcakton kërkesat për menaxhimin dhe përdorimin e këtyre mbeturinave, duke i specifikuar pragjet specifike për përdorimin e tyre në bujqësi. MMPHI-ja dhe Ministria e Bujqësisë janë përgjegjëse për menaxhimin e këtyre mbeturinave

Nuk ka të dhëna për trajtimin e llumit, ndërsa, sipas raportit të ASK-së për Statistikat e Ujit të Kosovës për vitin 2015 nuk ka trajtim të ujërave të zeza, ndërsa ujërat e zeza derdhen drejtpërdrejt në lumenj. Është një impiant i trajtimit në Llaushë, Skenderaj. Ky impiant u shërben ~ 10,000 njerëzve.

Derisa QTUZ-të vijnë në internet, do të ketë nevojë për t'i menaxhuar nënproduktet e llumit. Sasitë dhe natyra e llumit të prodhuar do të varet nga burimet e ujërave të zeza dhe teknologjia specifike që do të përdoret nga QTUZ-të. Në tërë Evropën, llumi i trajtuar i ujërave të zeza mund të përdoret përsëri në tokë si përmirësues i tokës, por vetëm aty ku ka kornizë të mirë të menaxhimit dhe rregullative.

3.3.10 Mbeturinat industriale dhe minerare

Pas vitit 1999 shumë qendra industriale kanë rënë nga funksioni. Këto objekte, posa janë braktisur, kanë lënë pas teknologji dhe ndërtesa të vjetra, dyqane që kanë mbetur të pamenaxhuara – kjo ka qenë përveç mbeturinave të parregulluara dhe deponive të ndotura rëndë me kimikate dhe metale të rënda që tani përbëjnë rrezik permanent për shëndetin publik. Shumë pak nga këto objekte kanë pronarë të rinj, ndërsa në ato që kanë është bërë vetëm një rehabilitim i pjesshëm.

Sasi të mëdha të kimikateve dhe mbetjet industriale dhe të minierave me përmbajtje të lartë të metaleve të rënda janë trashëguar nga industria kosovare e para luftës e kohës socialiste dhe kurrë nuk janë trajtuar. Për shkak të teknologjive të vjetra të përpunimit, të cilat nuk ka arritur ta mundësojnë përdorimin e mjaftueshëm të lëndëve të para, ka sasi të konsiderueshme të mbetjeve minerare në deponi dhe afër tyre, të cilat po shkaktojnë rreziqe të mëdha për mjedisin. Për më tepër, deponitë industriale, për aktivitete të ndryshme minerare, metalurgjike dhe kimike, paraqesin sfida të mëdha. Pikat e nxehta të mjedisit që janë shënjuar me sinjal të kuq sa i përket rrezikut të tyre ndaj shëndetit të njeriut, florës dhe faunës janë:



- Kompleksi industrial i Trepçës në komunën e Mitrovicës. 60 milionë ton mbeturina të rrezikshme minerare që përmbajnë sasi të konsiderueshme të metaleve të rënda.
- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-u) në komunën e Obiliqit. Hiri i deponuar dhe liqejtë e ujërave të zeza që rrjedhin nga prodhimi i energjisë i bazuar në linjit i kontaminojnë vazhdimisht ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe tokën.

- Kompleksi industrial i Ferronikelit në Glogovc. Mbeturinat e minierave të kontaminuara me metale të rënda po i rrezikojnë burimet e ujit.
- Deponitë e tjera të egra, kimikatet e mbetura nga fabrikat në të kaluarën, janë ripaketuar dhe ruhen përkohësisht në pika të caktuara në Kosovë, të cilat paraqesin rrezik të përhershëm për mjedisin.

3.3.11 Mbeturinat e rrezikshme

Inventari i mbeturinave të rrezikshme (IMRr-ve) e ofron një regjistër të mbeturinave të rrezikshme për Kosovën. Ky regjistër azhurnohet rregullisht në fund të çdo viti dhe është baza më gjithëpërfshirëse e të dhënave për prodhimin dhe deponimin e MRr-ve në dispozicion.

MRr-të prodhohen nga burime të shumta, duke përfshirë vendet minerare, industriale, komunale, mjekësore/veterinare dhe të ndërtimit mes tjerash. Në studim i Bankës Botërore që është zhvilluar në vitin 2015 i identifikon industrinë e parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes (PKIN) dhe pikat e nxehta (hot-spots) që gjenerojnë mbeturina të rrezikshme në Kosovë dhe paraqet pasqyrën më gjithëpërfshirëse të hartave të pikave të nxehta në vend ⁷.

Aktualisht komponentët e MRr-ve brenda mbeturinave të ngurta komunale nuk ndahen. Vlerësohet se nga 0.4% deri në 1.2% e mbeturinave komunale janë mbeturina të rrezikshme. Natyra e mbeturinave të rrezikshme që prodhohen nga amvisëritë po ndryshon me kalimin e kohës. Pritet që përqindja e mbeturinave elektronike të rritet gradualisht, përdërisa fraksionet e tjera potenciale të mbeturinave të rrezikshme (siç janë bojërat me bazë të tretshme) do të pakësohen në mënyrë të qëndrueshme.

Mbeturinat e rrezikshme në Kosovë menaxhohen dobët – zakonisht ruhen dhe deponohen në objekte të papërshtatshme dhe të rrënuara keq, duke mos i kushtuar rëndësi paketimit, etiketimit dhe ruajtjes së sigurt të tyre. Me mbështetjen e programit IPA III (2021-2027) të BE-së, duhet të përgatitet një plan për ndërtimin e një qendre për vendosjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme.

3.3.12 Mbeturinat e kujdesit shëndetësor

Mbeturinat e kujdesit shëndetësor (MKSh-të) janë mbeturina që prodhohen ose krijohen gjatë kryerjes së procedurave mjekësore ose nga prodhimi i produkteve farmaceutike. Mbeturinat e kujdesit shëndetësor duhet të ndahen në burim dhe të ndahen në fraksione të veçanta të mbeturinave të rrezikshme dhe të parrezikshme.

Në Kosovë të gjithë personat e përfshirë në menaxhimin e mbeturinave të kujdesit shëndetësor duhet të licencohen. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për menaxhimin dhe rregullimin e mbeturinave mjekësore që ndërlidhen me njerëzit, ndërsa Ministria e Bujqësisë është përgjegjëse për menaxhimin dhe rregullimin e mbeturinave të veterinarisë.

Sipas anketave, mbeturinat e prodhuara mjekësore arrijnë në 0.0024 kg/për kokë banori ose rreth 2014.5



⁷ Inventari i Materialeve të Mbeturinave të Rrezikshme (MMRr-ve) që prodhohen dhe ruhen në Kosovë, Raporti Vjetor i MEA-së, nëntor 2017.

tonë në vit. Vlerësohet se totali i MKSh-ve të prodhuara nga shtëpitë e shëndetit është ~ 315,000 kg/v, ndërsa vlerësohet se industria farmaceutike i prodhon ~ 70-75 ton/v/kb.

Janë gjashtë qendra shëndetësore në Kosovë me qendra të trajtimit të mbeturinave mjekësore në vend për sterilizim, kjo përbën ~ 25% të mbeturinave të prodhuara mjekësore, ndërsa mbeturinat e tjera dërgohen në deponinë komunale. Përveç kësaj, në Kosovë janë 4 incineratorë të mbeturinave të kujdesit shëndetësor.

Menaxhimi profesional i mbeturinave të kujdesit shëndetësor është prioritet i lartë. Ekzistojnë disa kategori të MKSh-ve që janë të rrezikshme. Ndonëse komponenti i rrezikshëm i MKSh-ve është fraksion i vogël e gjithsej mbeturinave që prodhohen në spitale dhe klinika, përveç nëse ka sisteme efektive të ndarjes së mbeturinave në burim në nivel të kirurgjisë/repartit/klinikës, të gjitha mbeturinat që vijnë nga këto objekte duhet të trajtohen si të rrezikshme.


3.4 Analizë

Gjendja për krahasim në sektorin e mbeturinave të ngurta komunale është analizuar duke i përdorur indikatorët e Standardit "Wasteaware" për MIMN-në (WABIs) WABI-të janë bërë standard ndërkombëtar për vlerësimin e kushteve ekzistuese. Ata ndihmojnë në identifikimin e prioriteteve dhe matjen e ndryshimeve në MIMN. Ato ndihmojnë për t'i identifikuar prioritetet dhe për t'i matur ndryshimet në MIMN. WABI-të janë duke u përdorur gjithnjë e më shumë si mjet matës për performancën e sektorit të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.

Përdorimi i këtij sistemi të standardizuar të vlerësimit i zbulon ngjashmëritë midis sistemeve të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave në Ballkanin Perëndimor. Këto rezultate janë paraqitur në diagramin "merimangë" më poshtë, duke përfshirë, në anën e djathtë, krahasimin me performancën e krahasuar të dy qyteteve të tjera të Evropës Juglindore, Sofjes (me ngjyrë të gjelbër) dhe Kluj-Napokas (me ngjyrë të kaltër).

Indikatorët teknikë që janë ilustruar në anën e majtë të diagrameve "merimangë" ilustrojnë se infrastruktura e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë po ngec prapa atyre të vendeve/qyteteve që tashmë kanë marrë mbështetje të konsiderueshme përmes granteve të BE-së për këtë sektor. Sa i përket "qeverisjes", siç është ilustruar në të djathtë të diagramit "merimangë", ka mjaft simetri midis situatës në Kosovë dhe në Kluj-Napoka, një qytet rumun. Vlerësimi i Sofjes e pasqyron një komunë që e ka përmirësuar dukshëm performancën e saj në aspektet organizative/institucionale dhe financiare.

		Performance				
		Low	Low-Medium	Medium	Medium-High	High
Physical components		Benchmark indicator				Kosovo
Public health - waste collection	1.1	Waste collection coverage (% households)				71
	1.2	Waste captured by solid waste management and recycling system (% wt.)				74.3
	1C	Quality of waste collection and street cleaning service (%)				63
Environmental control - disposal	2	Control treatment and/or disposal (% wt.)				66
	2E	Quality of environmental protection in waste treatment and disposal				46
Resource value - 3Rs: reduce, reuse, recycling	3	Recycling rate (% wt.)				3.3
	3R	Quality of 3Rs - reduce, reuse, recycle (%)				21
Governance factors		Benchmark indicator				Kosovo
Degree of user and provider inclusivity	4U	Degree of user inclusivity (%)				50
	4P	Degree of provider inclusivity (%)				50
Degree of financial sustainability	5F	Degree of financial sustainability (%)				71
Sound institutions and proactive policies	6N	Adequacy of national framework for solid waste management (SWM) (%)				58
	6L	Degree of local institutional coherence (%)				54



deponimit të mbeturinave.

4. Vetëm një pjesë shumë e vogël e mbeturinave riciklohet dhe ripërtërihet.
5. Duhet bërë më shumë punë për t'i përfshirë përdoruesit dhe ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave në sistem
6. Qëndrueshmëria financiare është brenda parametrin, por ende nuk është e garantuar.
7. Janë hartuar politika dhe janë themeluar institucione, por kapacitetet kanë nevojë për përforsim.

Prioritet është që të krijohen sisteme të veçanta për menaxhimin e fraksioneve të tjera të mbeturinave, në mënyrë që të sigurohet që këto materiale të mos hyjnë në mbeturinat e ngurta komunale, të përmirësohet rregullimi dhe kontrolli i të gjitha operacioneve të menaxhimit të mbeturinave dhe të zhvillohen sisteme të ndara të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave për disa mbeturina specifike.

MNRr-të përzihen me mbeturinat komunale, të cilat zakonisht deponohen në troje të hapura dhe nëpër shtretër të lumenjve. Në mënyrë të ngjashme, edhe mbeturinat e kafshëve dhe nënprodukteve të kafshëve ndodhtë përzihen me mbeturinat e ngurta komunale, duke e vënë kështu në rrezik shëndetin e punëtorëve dhe të publikut.

Nga aktivitetet industriale dhe minerare prodhohen sasi të mëdha të mbeturinave. . Praktikrat e menaxhimit të mbeturinave industriale duhet të përmirësohen dukshëm me kalimin e kohës, në mënyrë që t'i plotësojnë teknikrat më të mira të mundshme (TMM-të) kompatible me standardet evropiane.

Përveç kësaj, mbeturinat e tjera të veçanta janë theksuar si prioritete për aranzhimet e menaxhimit të llojit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. Këtu hyjnë mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE-të), akumulatorët, ambalazhi dhe mbeturinat e ambalazhit dhe automjetet e vjetruara (AV-të).

Në tabelën e mëposhtme janë renditur disa nga çështjet më kritike që po hasen në sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave dhe përgjigjet strategjike që duhet të merren parasysh.

Aspekti	Çështje kritike	Përgjigje strategjike
Shërbimet dhe infrastruktura	Shërbimet e mbledhjes së mbeturinave të ngurta komunale ende nuk janë zgjeruar aq sa për t'iu ofruar tërë popullatës.	Caktimi i mbulimit me shërbim në shkallë prej 100% si objektivi dhe mbështetja e tij me një kombinim të mbulimit me inkasim të avancuar, fonde për caqe të caktuara dhe stimuj të ndryshëm.
	Deponitë rajonale që nuk ia dalin t'i mbulojnë shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes dhe t'i përmbushin standardet mjedisore.	Përmirësimi i mekanizmave të pagesave për shërbimet rajonale të deponive.
	Mungesa kritike e kapacitetit të deponisë.	Zhvillimi i rrjetit të objekteve të transferimit, trajtimit dhe deponimit të mbeturinave.
	Mungesa e objekteve për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimin.	Krijimi i qendrave për menaxhimin e MNRr-ve.
	Rreziqet ndaj mjedisit, shëndetit dhe sigurisë nga mbeturinat e kafshëve dhe mbeturinat e kujdesit shëndetësor që hyjnë në rrjedhën e MNK-ve.	Forcimi i sistemeve të menaxhimit për mbeturinat e kafshëve dhe të kujdesit shëndetësor.
Kapaciteti profesional	Mungesa e profilit publik të industrisë së menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave	Njohja e industrisë dhe promovimi i profesionalizmit.
	Perspektivat e pasigurta të karrierës për ata që kërkojnë të hyjnë dhe të mbesin në këtë sektor.	Krijimi i sistemeve profesionale të strukturuar për mësim dhe akreditim.
	Shkalla e ulët e vlerësimit të punëtorëve të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave	Përmirësimi i imazhit publik të sektorit si industri e shërbimeve me rëndësi ekonomike, sociale dhe mjedisore.
Rregullimi dhe	Mungesa e mbledhjes së të dhënave	Sistematizimi i mbledhjes së të

kontrolli	dhe raportimit të rregullt për mbeturinat e ngurta komunale	dhënave dhe raportimit për prodhuesit, ofruesit e shërbimeve dhe qendrat e mbeturinave të ndryshme.
	Mungesa e raportimit të të dhënave nga industria	Forcimi i licencimit dhe lejimit, përfshirë obligimet e qarta për raportim të të dhënave.
	Efektiviteti i kufizuar i rregullimit dhe kontrollit nëpër fraksionet e ndryshme të mbeturinave dhe objektet e menaxhimit të mbeturinave.	Forcimi i standardeve të monitorimit dhe zbatimit.
Reduktimi, ripërdorimi dhe riciklimi	Vetëdija e ulët publike për mundësitë dhe avantazhet e parandalimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave	Popullarizimi i 3 R-ve përmes vetëdijesimit dhe edukimit publik, me fokus në shkollat.
	Realizimi i çaqeve evropiane të ekonomisë qarkore duket perspektivë e largët.	Filloni duke stimuluar të menduarit e 'ekonomisë qarkore', duke përfshirë parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave.

4. Objektivat

4.1 Vizioni

Vizioni i kësaj strategjie është:

Të mbrohet shëndeti publik dhe të zvogëlohet ndikimi i mbeturinave në mjedis, në të njëjtën kohë gjersa shtohen mundësitë për biznes dhe punësim dhe tranzicion drejt një ekonomie qarkore të harmonizuar me normat dhe standardet evropiane.

Strategjia synon t'i trajtojë të metat dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i përcaktuar dhe realizuar katër objektivat strategjike në vijim. Realizimi i këtyre objektivave strategjike do të luajë rol në shtyrjen e Kosovës përpara drejt potencialeve ekonomike dhe standardeve të jetesës.

Objektivat strategjike dhe specifike për këtë Strategji të Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave janë përcaktuar përmes një analize të problemeve dhe shkaqeve të tyre.

4.2 Objektivat strategjike dhe specifike

Problemet dhe shkaqet e tyre		Objektivat strategjike dhe specifike
PROBLEMI: Mbeturinat nuk menaxhohen për shkak të të metave në shërbim dhe boshllëqeve në infrastrukturë.	→	Objektivi strategjik: Zhvillimi i një gjenerate të re të shërbimeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbeturinave.
SHKAKU: Mungesa e mbulimit me shërbim dhe efikasiteti i ulët i shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave.	→	Objektivi specifik: Sigurimi i shërbimeve të rregullta dhe të besueshme të mbledhjes së mbeturinave të ngurta komunale për tërë popullatën.
SHKAKU: Rrjeti i papërshtatshëm i objekteve të menaxhimit të mbeturinave për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave të ngurta komunale.	→	Objektivi specifik: Zhvillimi i rrjetit të qendrave të menaxhimit të integruar të mbeturinave
SHKAKU: Fraksionet e tjera të mbeturinave hyjnë në rrjedhën e mbeturinave komunale duke u vënë barrë më të rëndë komunale.	→	Objektivi specifik: Zhvillimi i sistemeve dhe infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave jokomunale.

Problemi dhe shkaqet e tij		Objektivat strategjike dhe specifike
PROBLEMI: Menaxhimi dhe riciklimi i mbeturinave nuk është disiplinë profesionale e themeluar plotësisht.	→	Objektivi strategjik: Profesionalizimi i sektorit të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.
SHKAKU: Ka gjerësi dhe thellësi të pamjaftueshme të profesionistëve të kualifikuar që punojnë në sektorin e	→	Objektivi specifik: Vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve profesionale në sektorin publik

menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.		dhe privat.
SHKAKU: Menaxhimi dhe riciklimi i mbeturinave është sektori që nuk njihet formalisht si sektor industrial.	→	Objektivi specifik: Krijimi i një kodi industrial për sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave në statistikat kombëtare.
SHKAKU: Studentët kanë rrugë të kufizuara për të hyrë në profesionin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.	→	Objektivi specifik: Promovimi i kërkimit dhe zhvillimit në universitete.

Problemi dhe shkaqet e tij		Objektivat strategjike dhe specifike
PROBLEMI: Kërkesat ligjore nuk zbatohen si rezultat i mungesës së qartësisë dhe mekanizmave të dobët të zbatimit.	→	Objektivi strategjik: Forcimi i rregullimit dhe kontrollit në sektorin e menaxhimit të mbeturinave duke i plotësuar boshllëqet dhe duke i qartësuar mekanizmat e zbatimit.
SHKAKU: Nuk ekziston ndonjë sistem për mbledhjen rutinore të të dhënave dhe informacionit për menaxhimin e mbeturinave.	→	Objektivi specifik: Krijimi i një sistemi informativ gjithëpërfshirës dhe funksional për menaxhimin e mbeturinave.
SHKAKU: Licencat dhe lejet për objektet industriale dhe operatorët dhe objektet e menaxhimit të mbeturinave janë të paplota.	→	Objektivi specifik: Zgjerimi i sistemit të dhënies së licencave dhe lejeve për menaxhimin e mbeturinave për t'i mbuluar të gjitha mbeturinat, operatorët dhe qendrat e menaxhimit të mbeturinave.
SHKAKU: Mekanizmat e zbatimit janë joefektivë.	→	Objektivi specifik: Forcimi i mekanizmave zbatues, përfshirë komunat dhe inspektoratet.

Problemi dhe shkaqet e tij		Objektivat strategjike dhe specifike
PROBLEMI: Tempi i përmbushjes së kërkesave të BE-së pengohet nga shkalla e ulët e vetëdijes publike dhe interesimit të bizneseve.	→	Objektivi strategjik: Promovimi i vlerave dhe praktikave të një ekonomie qarkore.
SHKAKU: Shkalla e ulët e vetëdijes publike është pengesë kryesore për të bërë përparim në praktikën e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.	→	Objektivi specifik: Ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.
SHKAKU: Asnjë vëmendje nuk u kushtohet avantazheve ekonomike të parandalimit të prodhimit të mbeturinave.	→	Objektivi specifik: Stimulimi i inovacionit në parandalimin e mbeturinave.
SHKAKU: Nuk ka sistem funksional të ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave.	→	Objektivi specifik: Krijimi i sistemeve të ripërdorimit dhe riciklimit bazuar në konceptin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Objektivat strategjike dhe specifike shtohen në një agjendë reformuese gjithëpërfshirëse dhe të arritshme për sektorin e mbeturinave. Të marra së bashku, ato ofrojnë një përgjigje kuptimplotë, të zbatueshme dhe në përputhje me adresimin e problemeve aktuale në sektorin e mbeturinave.

Services and infrastructure	Professionalisation
Waste collection services	Capacity building
Integrated waste management facilities	Sector recognition
Other wastes	Research & development
Regulatory standards	Circular economy
Waste management information system	Public awareness & education
Licensing and permitting	Waste prevention
Enforcement mechanisms	Reuse and recycling

4.3 Objektivi strategjik 1: Shërbimet dhe infrastruktura

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1

Zhvillimi i nje gjenerate te re per shërbime te integruara per menaxhimin e dhe deponimin e mbeturinave.

Investimi i vazhdueshëm publik në shërbime dhe infrastrukturë është i nevojshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe disa mbeturinave të tjera. Me kalimin e kohës, investimet duhet të bëhen nga të hyrat e mbledhura për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave, por në këtë fazë nuk ka të ardhura të mjaftueshme për t'i mbuluar nevojat dhe ekziston një hendek i qartë sa i përket financimit. Si rezultat, menaxhimi i mbeturinave në Kosovë mbështetet në mënyrë të konsiderueshme në dhënien e granteve dhe kredive koncesionale nga partnerët ndërkombëtarë për zhvillim, në mënyrë që të plotësohet financimi në dispozicion.

Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave fillojnë me mbledhjen/mbledhjen e ndarë të materialeve nga amvisëritë, bizneset dhe institucionet. Për t'i kryer këto punë nevojiten automjete dhe pajisje, ndërsa këto asete duhet të mirëmbahen dhe zëvendësohen me kalimin e kohës. Burimi primar i financimit për blerjen/zëvendësimin e automjeteve dhe pajisjeve duhet të jetë tarifa e mbeturinave, por në planin afatshkurtër parashihet një mbështetje me anë të financimit përmes granteve.

Është vlerësuar një shumëllojshmëri e opsioneve për transferimin e mbeturinave komunale dhe infrastrukturën e deponive. Infrastruktura kryesore përbëhet nga një rrjet rajonal i integruar i transfer stacioneve dhe deponive sanitare. Pritet që investimi përmes granteve të rrjedhë natyrshëm drejt atyre impianteve dhe shërbimeve që veprojnë në nivel rajonal/ndërkomunal, pasi këto do ta sjellin ndikimin dhe qëndrueshmërinë më të madhe.

Infrastruktura e financuar nga publiku është gjithashtu e nevojshme për një përzgjedhje të llojeve të mbeturinave të tjera jokomunale. ri kategori të mbeturinave (mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit, nënproduktet e kafshëve dhe mbeturinat e kujdesit shëndetësor) gjenden rregullisht të përziera me mbeturinat komunale. Financimi publik nevojitet për ndërtimin e infrastrukturës, në mënyrë që këto fraksione të mbeturinave të mund të menaxhohen ndaras nga MNK-të dhe që të përmirësohet performanca e menaxhimit të sistemit të MNK-ve.

Një pjesë e konsiderueshme e investimit të nevojshëm është programuar në Listën e Vetme të Projekteve Prioritare (LVP) në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (KIBP). LVP-ja e mbulon periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2020 dhe do të jetë burimi kryesor i investimeve në shërbimet dhe infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave për këtë periudhë.

4.3.1 Shërbimet e mbledhjes së mbeturinave

Objektivi specifik 1.1

Sigurimi i shërbimeve të rregullta dhe të besueshme të mbledhjes së mbeturinave të ngurta për tërë popullatën.

Mbledhja e mbeturinave është shërbim publik i domosdoshëm, i nevojshëm për kushtet e shëndetshme të jetesës së popullatës dhe për mbrojtjen e cilësisë së mjedisit. Komunitetet janë ligjërisht përgjegjëse për të siguruar se ofrohen shërbime të rregullta dhe të besueshme të mbledhjes së mbeturinave dhe duhet ta sigurojnë performancën efikase dhe të qëndrueshme të këtyre shërbimeve.

Komunitetet mund të ofrojnë shërbime të mbledhjes së mbeturinave ose drejtpërdrejtë vetë, përmes Kompanive Rajonale të Mbeturinave (KRM-ve), ose përmes sektorit privat. Është detyrë e komunitetit që të vendosin për aranzhimin e ofrimit të këtyre shërbimeve dhe për ta siguruar efikasitetin e përgjithshëm dhe qëndrueshmërinë e shërbimit. Komunitetet duhet ta përmirësojnë performancën e tyre në inkasim, menaxhim të ofrimit të shërbimeve, zëvendësim të aseteve, vetëdijësim të publikut dhe evitim dhe pastrim të mbeturinave të hedhura në mënyrë të paligjshme.

Indikatori i rezultatit

Përqindja e popullsisë së përgjithshme me qasje në shërbime adekuate dhe të rregullta të mbledhjes e mbeturinave komunale

Baza për krahasim: < 70% në vitin 2018

Caqet: 80% në vitin 2023, 100% në vitin 2026

4.3.2 Qendrat e menaxhimit të integruar të mbeturinave


Objektivi specifik 1.2

Zhvillimi i rrjetit të qendrave të menaxhimit të integruar të mbeturinave

Avancimi i infrastrukturës së menaxhimit të mbeturinave të ngurta komunale është zemra e kësaj Strategjie. Kosova e ka arritur pikën në të cilën kapaciteti i deponive mungon shumë. Duhet të ndërmerren masa urgjente për t'i avancuar dhe zgjeruar deponitë ekzistuese dhe për të ndërtuar deponi të reja në disa rajone. Fokusi do të jetë në konsolidimin e kushteve teknike të deponive. Ky investim do të shpaguehet në të ardhmen, meqë do të sigurojë që të trajtohen ndikimet në mjedis dhe të menaxhohen borxhet afatgjata.

Deponia e Pejës do të zgjerohet, ndërsa një deponi e re do të identifikohet për t'i shërbyer rajonit të Prishtinës. Deponitë e tjera rajonale do të avancohen, do të vazhdojnë të funksionojnë ose do të mbyllen dhe rehabilitohen, sipas nevojave dhe orarit të përcaktuar. Transfer stacionet ekzistuese në Ferizaj, Drenas dhe Gjakovë do të vihen në përputhje me standardet, ndërsa transfer stacione të reja do të ndërtohen në Istog, Klinë, Skenderaj dhe Novobërdë. Një transfer stacion tjetër është planifikuar të ndërtohet në Malishevë.

Në hartën e mëposhtme është paraqitur konfigurimi gjeografik i sistemit të menaxhimit të integruar të mbeturinave të ngurta. Konfigurimi përfundimtar i sistemit dhe konfirmimi i deponive do të përcaktohen përmes Studimit të Fizibilitetit, ndërsa do të realizohet sipas procedurave të planifikimit dhe dhënies së lejeve.



Indikatori i rezultatit

Përqindja e totalit të mbeturinave të ngurta komunale të prodhuara që menaxhohen në qendra të kontrolluara (d.m.th. duke përfshirë deponinë sanitare dhe/apo qendrat

e ripërtëritjes/riciklimit të materialeve termike dhe biologjike.

Baza për krahasim <40%

Caqet 60% deri në 2023, 80% deri në 2027, 100% deri në vitin 2030

4.3.3 Mbeturinave të tjera

Objektivi specifik 1.3


Zhvillimi i sistemeve dhe infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave të tjera.

Kjo Strategji përfshin zhvillimin e shërbimeve dhe infrastrukturës për mbeturinat e tjera (jo komunale) që i kontaminojnë rregullisht mbeturinat komunale.

Kontaminimi nga mbeturinat e tjera i përfshin mbeturinat e vëllimshme (nga amvisëritë), mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimin (nga projektet e ndërtimit), nënproduktet e kafshëve (nga mishtoret dhe tregjet) dhe mbeturinat e kujdesit shëndetësor (nga spitalet dhe klinikat). Kur këto mbeturina të tjera hyjnë në sistemin e MNK-ve, kjo e bën ofrimin e shërbimeve më të ndërlikuar dhe më të shtrenjtë dhe mund të sjellë rrezik të madh shtesë për shëndetin dhe sigurinë në punë (ShSP), veçanërisht për stafin e mbledhjes së mbeturinave.

Mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimin Do të ndërtohet një rrjet i integruar i qendrave të MNRr-ve. LVP përfshin sigurimin e qendrave të menaxhimit të MNRr-ve në Gjilan, Ferizaj dhe Prizren, si dhe vendet e caktuara për Shtërpçë, Rahovec, Gjakovë, Shtime, Lipjan, Drenas, Suharekë, Kaçanik dhe Viti. Për Prishtinë, Pejë dhe Mitrovicë nevojiten qendra shtesë. Këto qendra parashikohet që të krijohen në vitet e para të zbatimit të Strategjisë, duke u dhënë prioritet qendrave të mëdha urbane së pari.

Komunat janë përgjegjëse për organizimin dhe financimin e menaxhimit të MNRr-ve në territoret e tyre dhe mund t'ua delegojnë operimin e këtyre qendrave në KRM-ve ose sektorit privat. MMPHI-ja do t'i shqyrtojë mundësitë për krijimin e kushteve të favorshme kornizë për përfshirjen e sektorit Privat në përpunimin e MNRr-ve.



Mbeturinave të nënprodukteve të kafshëve: Nënproduktet e kafshëve (NPK-të) që prodhohen nga thertoret dhe mishtoret si dhe gjatë festave fetare janë rrjedhë problematike e mbeturinave në Kosovë. Masa specifike duhet të ndërmerren për të siguruar që këto mbeturina të mos hyjnë në rrjedhën e mbeturinave të ngurta komunale, por të devijohen në qendrat e trajtimit.

Një impiant qendror i trajtimit për deponimin e nënprodukteve të kafshëve do të ndërtohet me mbikëqyrjen e AUVK-së, në të cilën planifikohet që të mblidhen të gjitha NPK-të nga mbarë vendi dhe të dezinfektohen para deponimit të sigurt në deponinë e Prishtinës. Një plan i menaxhimit të mbeturinave të NPK-ve do të përgatitet nga MMPHI-ja në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës. Në të do të kërkohet që të përcaktohet një politikë dhe kornizë koherente kombëtare për menaxhimin e mbeturinave të NPK-ve dhe do t'i përmbajë investimet e nevojshme për t'u zhvilluar në përputhje me kërkesat evropiane. Kjo do ta përfshijë përdorimin e teknikave më të mira në dispozicion me një menaxhim të ciklit të plotë për mbeturinat e NPK-ve për tërë vendin, duke zgjeruar infrastrukturën e qendrës së instaluar për ta përfshirë trajtimin përfundimtar (p.sh. djegjen).

Mbeturinat e kujdesit shëndetësor: nga spitalet, klinikat, dentistët dhe qendrat mjekësore të tjera përbëjnë rrjedhë të mbeturinave të prioritetit më të lartë. Procedurat standarde operative për menaxhimin e mbeturinave të kujdesit shëndetësor do të hartohen dhe miratohen, duke u përqendruar në ndarjen e llojeve të mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në burim. Vëmendje do t'i kushtohet të siguruarit që prodhuesit e mbeturinave të kujdesit shëndetësor të kenë qasje të arsyeshme në sistemet profesionale të menaxhimit.

Për ta përmirësuar menaxhimin e mbeturinave të kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet, një plan për menaxhimin e MKSh-ve do të përgatitet për ta mundësuar një sistem të menaxhimit gjithëpërfshirës. Një plan për menaxhimin e mbeturinave të kujdesit shëndetësor do të hartohet nga Ministria, në bashkërendim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë.

Indikatori i rezultateve

Është krijuar një sistem për menaxhimin e ndarë të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimin

[Baza për krahasim](#) Nuk ka sistem të veçantë për MNRr-të

[Caku](#) Së paku tri qendra të MNRr-ve krijohen deri në vitin 2024

Indikatori i rezultateve

Planet e menaxhimit të mbeturinave (PMM-të) janë shtjelluar, miratuar dhe publikuar për nënproduktet e kafshëve dhe mbeturinat e kujdesit shëndetësor

[Baza për krahasim](#) Nuk ka PMM

[Caku](#) Plani i menaxhimit të mbeturinave të kujdesit shëndetësor publikohet deri në vitin 2023

Plani i menaxhimit të mbeturinave të kafshëve dhe nënprodukteve të kafshëve publikohet deri në vitin 2024

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënimin publikohet deri në vitin 2023

Kapacitetet e trajtimit për MNRr-të, NPK-të dhe MKSh-të shtrihen në tërë Kosovën deri në vitin 2030

4.4 Objektivi strategjik 2: Profesionalizimi

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2

Profesionalizimi i sektorit të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.

Mbrojtja e shëndetit publik dhe mjedisit mund të sigurohet vetëm nëse industria e menaxhimit të mbeturinave u përmbahet standardeve profesionale. Industria kosovare e menaxhimit të mbeturinave përbëhet nga një kuadër divers i profesionistëve me përvojë në lëmenj profesionale të ndryshëm. Gjatë viteve të fundit, organet komunale dhe të industrisë si AKK-ja dhe PAMKOS kanë qenë dinamo në përmirësimin e standardeve profesionale. Ne duhet të vazhdojmë në atë drejtim me mbështetjen e universiteteve, komunave dhe industrisë më të gjerë të menaxhimit të mbeturinave. Ministria e Administratës Publike (MPB-ja) do të sigurojë që të gjithë nëpunësve publikë t'u ofrohet trajnim i orientuar i certifikuar për menaxhimin e mbeturinave.

4.4.1 Ndërtimi i kapaciteteve

Objektivi specifik 2.1

Vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve profesionale në sektorin publik dhe privat.

Për shumë vite, Kosova ka përfituar shumë nga mbështetja që partnerët ndërkombëtarë për zhvillim e kanë ofruar për sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i ndërtuar kapacitetet e sektorit të menaxhimit të mbeturinave. Mbështetja gjithëpërfshirëse ka përfshirë përgatitjen e kornizës ligjore dhe rregullative, investimet në infrastrukturë dhe pajisje, përgatitjen e planeve dhe projekteve, procedurat e të dhënave dhe menaxhimit, themelimin dhe trajnimin e operatorëve dhe mbështetjen për ngritjen e vetëdijes dhe të niveleve të pjesëmarrjes së komunitetit.

Vëmendja tani duhet të përqendrohet në ndihmën që duhet t'u ofrohet komunave për t'i konsoliduar shërbimet e tyre të menaxhimit të mbeturinave dhe sistemet e financimit publik, në të njëjtën kohë me forcimin e kapacitetit për ta menaxhuar rrjetin e qendrave të menaxhimit të integruar të mbeturinave. MMPHI-ja dhe AMMK-ja po ashtu kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme për t'i konsoliduar kushtet kornizë të sektorit, me fokus në përmirësimin e rregullimit dhe kontrollimit të mbeturinave komunale dhe mbeturinave prioritare të tjera.

Fushat ku nevojitet mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve përfshijnë, por nuk kufizohen me:

Monitorimin e zbatimit të strategjisë	Përcaktimin e standardeve, kodeve dhe udhëzimeve
Menaxhimin e programeve	Përgatitjen e projekteve
Legjislacionin, rregulloret dhe aktet nënligjore	Sistemin Informativ për Menaxhimin e Mbeturinave
Rregulloren dhe protokollet e kontrollit	Procedurat e dhënies së licencave dhe lejeve dhe inspektimit
Planifikimin e menaxhimit të integruar të mbeturinave	Planet e menaxhimit të mbeturinave të veçanta
Menaxhimin e mbeturinave industriale dhe të rrezikshme	Përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit
Sistemet e Rikthimit të Depozites (SRD)	Ekonominë dhe financat
Fizibilitetin dhe dizajnin	Specifikacionet teknike dhe prokurimin
Statistikat dhe kodin e industrisë	Hulumtimin dhe zhvillimin

Vetëdijesimin e publikut dhe ndryshimin e Njohjen dhe integrimin e sektorit joformal sjelljes

Parandalimin e mbeturinave

Ripërdorimin dhe riciklimin

Indikatori i rezultateve

Një program gjithëpërfshirës për zhvillimin e kapaciteteve zbatohet me fokus në përmirësimin e kapaciteteve të personelit që punon në qeverinë qendrore, kompanitë publike dhe komunat.

Zyrtarët publikë që punojnë në sektorin e menaxhimit të mbeturinave janë në gjendje t'i drejtojnë proceset vendimmarrëse në nivel qendror dhe komunal, ka dialog dhe komunikim të përmirësuar midis qeverisë qendrore dhe komunale dhe reputacion profesional të shtuar të atyre që punojnë në industrinë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave .

Baza për krahasim: Zhvillimi i kapaciteteve po sigurohet nga partnerët për zhvillim.

Caku: Raportet e rregullta të monitorimit të zbatimit të programit të zhvillimit të kapaciteteve tregojnë rritje të vazhdueshme të kapaciteteve të aktorëve relevantë për shkak të masave të zbatuara, duke u përqendruar në aftësinë e zyrtarëve publikë për t'i drejtuar proceset, në cilësinë e dialogut dhe komunikimit midis qeverisë qendrore dhe saj lokale dhe në reputacionin profesional.

4.4.2 Njohja e sektorit

Objektivi specifik 2.2

Krijimi i një kodi industrial për sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave në statistikën kombëtare.

Është koha që sektori i menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave të njihet zyrtarisht. 'Menaxhimi dhe riciklimi i mbeturinave' (ose ndonjë klasifikim tjetër i përshtatshëm) do të përfshihet si kod specifik në statistikën kombëtare, duke mundësuar që të raportohet për veprimtarinë afariste dhe punësimin në këtë sektor. Vëmendje do t'i kushtohet gjetjes së mënyrave për përfshirjen e të dhënave të mbledhura nga sektori joformal i riciklimit në statistika.

Industria kosovare e menaxhimit të mbeturinave e ka arritur pikën kur ka nevojë për një strukturë dhe platformë të rrjetit të kësaj industrie. Industria e menaxhimit të mbeturinave inkurajohet që ta formojë ndonjë shoqatë, odë apo institut përfaqësues dhe që pastaj ta krijojë një mekanizëm për aftësim profesional dhe certifikim/akreditim që mund t'u shërbejë nevojave të anëtarëve të saj.

Indikatori i rezultit

Industria e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave përfshihet në statistikën kombëtare deri në vitin 2023

Baza për krahasim: Nuk ka njohje

Objektivi: Përfshirja e profesioneve dhe bizneseve deri në vitin 2023

Indikatori i rezultatit

Themelohet organi përfaqësues i industrisë së menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave deri në vitin 2023

Baza për krahasim: Nuk ka organ përfaqësues për këtë industri

Objektivi: Organi i industrisë themelohet deri në vitin 2023

4.4.3 Hulumtimi dhe zhvillimi

Objektivi specifik 2.3

Promovimi i hulumtimit dhe zhvillimit në universitete.

Fokusi që BE-ja e ka vënë në ekonominë qarkore do të thotë se Evropa po kalon në një drejtim me njerëz tejet të shkathtë dhe të mençur dhe efikas për nga shfrytëzimi i resurseve. Potencialet e ardhshme për karrierë për të rinjtë tanë varen nga cilësia e institucioneve tona të arsimit terciar. Universiteteve u bëhet thirrje që t'i përmirësojnë dhe zhvillojnë kurset dhe programet mjedisore të tyre dhe të vazhdojnë të kërkojnë fonde për hulumtime dhe shkëmbime me universitetet e tjera evropiane.

Indikator i rezultatit

Është themeluar kursi (ose moduli) universitar për menaxhimin e integruar të mbeturinave të ngurta (MIMN-në)

Baza për krahasim: Nuk ka ndonjë kurs apo modul për MIMN-në

Objektivi: Kursi ose moduli i MIMN-së krijohet në universitet deri në vitin 2025

Të diplomuarit e kualifikuar që hyjnë në tregun e punës në MMN deri në vitin 2028

4.5 Objektivi strategjik 3: Rregullimi dhe kontrolli

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3

Forcimi i rregullimit dhe kontrollit në sektorin e menaxhimit të mbeturinave duke i plotësuar zbrazëtitrat dhe qartësuar mekanizmat e zbatimit.

Duhet të krijohen rregullore dhe procedura të kontrollit dhe mekanizma më efektivë të zbatimit për të siguruar që praktikrat e menaxhimit të mbeturinave të mos gravitojnë kah emërtimi i përbashkët më i ulët. Sistemi i dhënies së licencave dhe lejeve duhet të zgjerohet për t'i mbuluar të gjitha mbeturinat dhe operatorët dhe qendrat e mbeturinave. Kërkesat rregullative dhe mekanizmat e zbatimit duhet të shtrëngohen, ndërsa AMMK-ja, komunat dhe inspektoratet duhet të punojnë në partneritet për t'i identifikuar dhe ndjekur ata që vazhdojnë t'i hedhin mbeturinat e tyre ilegalisht në mjedis dhe që kryejnë krime mjedisore të tjera.

4.5.1 Sistemin Informativ për Menaxhimin e Mbeturinave

Objektivi specifik 3.1

Krijimi i një sistemi informativ gjithëpërfshirës dhe funksional për menaxhimin e mbeturinave.

Një sistem informativ i menaxhimit të mbeturinave po zhvillohet nga AMMK-ja me mbështetjen e Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA-n). Me kalimin e kohës, the funksionaliteti i Sistemit Informativ Mjedisor (SIM-së) do të zgjerohet për të siguruar bazën për rregullim dhe kontroll në sektorin e mbeturinave dhe do të përmbajë të dhëna për operatorët e licencuar dhe qendrat për të cilat janë dhënë leje, raportet e inspektimit dhe monitorimit dhe masat

e ndërmarra për zbatim. Ky sistem do ta ofrojë bazën për monitorimin e raportimit për arritjet e Kosovës në kuptim të arritjes së caqeve evropiane.

Indikatori i rezultatit

Ka sistem informativ për menaxhimin e mbeturinave që është gjithëpërfshirës, funksional dhe i qasshëm për publikun

Baza për krahasim: AMMK-ja e publikon një raport vjetor për MMN-në

Objektivi: SIMM-i është funksional në vitin 2021 dhe i qasshëm për publikun në vitin 2023

4.5.2 Dhënia e licencave dhe lejeve

Objektivi specifik 3.2

Zgjerimi i sistemit të dhënies së lejeve për menaxhimin e mbeturinave për t'i mbuluar të gjitha mbeturinat, operatorët dhe qendrat e menaxhimit të mbeturinave.

Zgjerimi i sistemit të dhënies së lejeve për t'i mbuluar të gjitha mbeturinat, operatorët dhe qendrat e menaxhimit të mbeturinave është prioritet. Sistemet e dhënies së lejeve për mbeturinat e ngurta komunale janë relativisht të mira. Megjithatë, sistemet për dhënien e lejeve për menaxhimin e mbeturinave industriale (të rrezikshme dhe të parrezikshme) duhet të përmirësohen ndjeshëm.

Duhet të ndërmerren veprime specifike për ta filluar përparimin në mbeturinat (mbetjet e rrezikshme dhe të parrezikshme) industriale.

- Ruajtja dhe azhurnimi i Inventarit të Mbeturinave të Rrezikshme (IMMRr-ve).
- Përgatitja e një Plani për Menaxhimin e Mbeturinave Industriale
- Forcimi i kompetencave ligjore dhe zbatuese.
- Ndërtimi i qendrës për magazinimin e mbeturinave të rrezikshme
- Kërkimi i teknikave më të mira të mundshme (TMM-ve) në licenca dhe leje.

Eksportimi i mbeturinave të rrezikshme në qendrat e licencuara evropiane do të kërkohet pashmangshëm kohë pas kohe. Kosova është e përkushtuar që t'i zbatojë dispozitat e Konventave të Bazelit, Roterdamit dhe Stokholmit (BRS), duke përfshirë përmbushjen e kërkesave për raportim të Sekretariatit të BRS-së.

Indikatori i rezultatit

Dhënia e lejeve për qendrat e menaxhimit të mbeturinave realizohet për të gjitha fraksionet e mbeturinave

Baza për krahasim: Mbulimi i pjesshëm i dhënies së licencave dhe lejeve për menaxhim të mbeturinave

Objektivi: Leje lëshohen për të gjitha qendrat e menaxhimit të mbeturinave deri në vitin 2027

Indikatori i rezultatit

Ka plan të menaxhimit të mbeturinave industriale (të rrezikshme dhe të parrezikshme).

Baza për krahasim: Nuk ka plan

Objektivi: Plani i menaxhimit të mbeturinave industriale publikohet deri në vitin 2022

Industritë e mëdha kanë i kanë hartuar dhe dorëzuar planet e menaxhimit të mbeturinave industriale sipas lokacioneve specifike deri në vitin 2022

4.5.3 Mekanizmat e zbatimit

Objektivi specifik 3.3

Forcimi i mekanizmave të zbatimit që përfshijnë komunitet dhe inspektoratet

Ka nevojë që të qartësohet dhe forcohet efektiviteti i legjislacionit dhe rregulloreve, duke mësuar nga përvoja e fituar gjatë zbatimit. Ka nevojë të qartë për t'i përmirësuar mekanizmat e zbatimit të ligjit dhe rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave. Komunitet dhe inspektoratet do t'i përforcojnë dhe sistemojnë procedurat e zbatimit. Kurdo që të jetë e nevojshme dhe e paraparë me ligj, do të jepet kompetenca të reja për zbatim, në mënyrë që autoritetet përgjegjëse t'u mundësohet që të merren me krimin mjedisor.

Indikatori i rezultatit

Përmirësohet zbatimi i kërkesave ligjore nga gjeneratorët dhe operatorët e mbeturinave.

Baza për krahasim: Mekanizmat e zbatimit dhe ekzekutimit janë jo adekuate

Caqet: : Mekanizmat dhe procedurat e zbatimit rishikohen deri në vitin 2022, ndërsa për të paktën 75% të shkeljeve të raportuara ekzistojnë mekanizmat dhe procedurat përkatëse të zbatimit që përdoren nga autoritetet kompetente deri në vitin 2024

4.6 Objektivi strategjik 4: Ekonomia qarkore


OBJEKTIVI STRATEGJIK 4

Promovimi i vlerave dhe praktikave të një ekonomie qarkore.

Me kalimin e kohës, shërbimet e menaxhimit të mbeturinave do të bëhen më komplekse, me krijimin gradual të sistemeve të mbledhjes me kontejnerë të shumtë dhe me publik, biznese dhe institucione nga të cilat do të kërkohej që të bashkëveprojnë me shërbimet e menaxhimit të mbeturinave në mënyra të ndryshme.

Një ndryshim kulturor i qëndrimeve dhe sjelljes është i nevojshëm për ta mbështetur këtë tranzicion. Gjeneratat e reja po sjellin me vete energji dhe pritshmëri të reja. Ne duhet të përfitojmë nga kjo për ta stimuluar një gjeneratë të re të qytetarëve të vetëdijshëm për burimet dhe për rëndësinë e ruajtjes së tyre.

Gjatë viteve të fundit janë krijuar vlerat dhe praktikat e një ekonomie qarkore dhe BE-ja e ka përcaktuar një politikë të re ambicioze për të lëvizur në këtë drejtim si shoqëri.



4.6.1 Vetëdijesimi dhe edukimi

Objektivi specifik 4.1

Ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.

Që çfarëdo politike, sistemi, shërbimi apo teknologjie të arrijë sukses pozitiv dhe të qëndrueshëm, është qenësore që të fitohet mbështetja e vullnetshme dhe proaktive e qytetarëve. As sistemet më të avancuara teknikisht nuk do të funksionojnë – e me gjasë edhe do të dështojnë – po që se gjërat e duhura nuk vihen në binarët e duhur në kohën e duhur. Edhe sjellja e njeriut ndikon në koston e trajtimit të mbeturinave, ekzistimin e deponive ilegale si dhe ambicjet lokale, rajonale dhe globale për ta reduktuar ndotjen plastike.



Veprimi i parë do të jetë që kjo Strategji të komunikohet dhe objektivat dhe synimet kryesore të Strategjisë që të publikohen në një mënyrë që ua tërheq vëmendjen njerëzve. Do të dizajnohen dhe lansohen fushata të vetëdijesimit publik dhe ndryshimit të sjelljes. Temat kryesore për këto fushata do të jenë: lufta kundër hedhjes ilegale të mbeturinave, ripërdorimi, riciklimi dhe hedhja ilegale e mbeturinave.

Qëndrimet ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe ruajtjes së resurseve fillojnë dhe formohen në klasë. Fëmijët ofrojnë shtysë dhe optimizëm për një të ardhme mjedisore më të qëndrueshme në Kosovë. Të mësuarit e strukturuar do të futet në planprogramin shkollor. Përmbajtja dhe cilësia e planprogrameve që kanë të bëjnë me mjedisin në secilën fazë kryesore të arsimit do të rishikohet dhe përditësohet. Kjo do të sigurojë relevancën e temave që përshtaten me prioritetet kombëtare dhe globale.

Indikatori i rezultatit

Ndikimi i matur i fushatave për vetëdijesim vlerësohet dhe publikohet deri në vitet 2024, 2027 dhe 2030.

Baza për krahasim: Nuk realizohet ndonjë fushatë e veçantë e vetëdijesimit

Caqet: Ndikimet e fushatave publikohen në vitet 2024, 2027 dhe 2030

4.6.2 Parandalimi i mbeturinave

Objektivi specifik 4.2

Stimulimi e risive në parandalimin e mbeturinave.

BE-ja është duke i kushtuar vëmendje të mprehtë parandalimit të mbeturinave. Kjo vjen si përgjigje ndaj pakos së ekonomisë qarkore të BE-së, Direktivës së re për Mbeturinat të vitit 2018 dhe të kuptuarit të ndikimit global të problemit të ndotjes detare dhe opinionit publik të përhapur kundër përdorimit të produkteve plastike për një përdorim. Ligji për Mbeturinat duhet të ndryshohet gjatë viteve në vijim për ta transpozuar Direktivën e re për Mbeturinat.

mbeturinave elektronike (MPEE-të) zbatohet një parim tjetër; që edhe kompanitë që plasojnë mallra në treg, pra "prodhuesit", duhet të përfshihen në organizimin dhe financimin e sistemeve të nevojshme për ripërdorimin, riciklimin dhe menaxhimin e materialeve pas konsumimit.

Kosova synon të përparojë drejt zbatimit të Përgjegjësisë së Përhapur të Prodhuesit (PZP-së), duke u fokusuar fillimisht në mbeturinat e ambalazhit dhe pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE-të), bateritë dhe automjetet. Skema të ndryshme do të zbatohen për secilën nga këto katër fraksione të produkteve/mbeturinave prioritare.

Për MPEE-të dhe bateritë, sistemet duhet të dizajnohen, organizohen, financohen dhe përdoren nga prodhuesit e sektorit privat. Industria inkurajohet që të paraqesë propozime për mekanizmat e PZP-së që i mbulojnë fraksionet e ndryshme të mbeturinave elektronike.

Për ambalazhin do të zbatohet një sistem hibrid i PZP-së. Preferohet që operimi i sistemit të realizohet nga një Organizatë e licencuar e Përgjegjësisë së Prodhuesit e krijuar nga prodhuesit dhe që cilado komunë, ndërmarrje publike apo kontraktues privat t'i ofrojë shërbimet e mbledhjes së ndarë dhe klasifikimit. Aranzhimet dhe ndërlidhjet e sakta midis pjesës përbërëse të sistemit do të krijohen dhe shqyrtohen gjerësisht.

Për automjetet e vjetruara, do të dizajnohet dhe zbatohet një sistem i administruar publikisht që përfshin një tarifë mjedisore që duhet të paguhet në kohën e regjistrimit të parë të automjeteve në Kosovë. Kantieret e licencuara të mbeturinave të hekurit do të jenë në gjendje ta kërkojnë kthimin e shpenzimeve të riciklimit/menaxhimit të automjeteve të vjetruara, me kusht që të dëshmojnë se i kanë plotësuar kërkesat rregullative dhe, në veçanti, se i kanë respektuar kontrollet mjedisore gjatë çmontimit të automjeteve dhe se i kanë realizuar objektivat e ripërdorimit dhe riciklimit.

Sistemet e drejtuara nga industria mund të përfshijnë skemat e kompensimit në deponim, prej nga në produkte, p.sh. në ambalazhet e pijeve, caktohet një depozitë e vogël, e cila pastaj 'kompensohet' kur ambalazhi kthehet për riciklim. Vendimet për llojin e skemave të PZP-së dhe sferat e përgjegjësisë do të merren në bazë të konsultimeve me industrinë përkatëse dhe aktorët e tjerë.

Objektivat evropiane do të hyjnë në fuqi për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave komunale të biodegradueshme që duhet të deponohen. Këto objektiva do të çojnë në një situatë në të cilën do të kërkojnë investime të mëdha për paratrazhimin e mbeturinave komunale. Në këtë fazë, fokusi është në bërjen e hapave fillestar, duke u fokusuar në kompostimin shtëpiak dhe kompostimin e mbeturinave të gjelbra. Në një fazë të mëvonshme mund të ketë kuptim që në konsideratë të merren burimet e përziera të mbeturinave biologjike, duke përfshirë mbeturinat organike nga tregjet, impiantet e trajtimit të ujërave të zeza dhe disa industri të përpunimit të ushqimit.

Indikatori i rezultatit

Mekanizmat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit përdoren për fraksionet e produkteve/mbeturinave.

Baza për krahasim: 0

Caku: Deri në vitin 2024, Kater (4) - kategori të fraksioneve/fraksione të produkteve/mbeturinave (ambalazhi, MPEE-të, bateritë, automjete e vjetruara).

5. Zbatimi, monitorimi dhe raportimi

Kjo strategji është fokusuar në veprime realiste dhe të zbatueshme. Në këtë kapitull shpjegohet se si do të strukturohet, drejtohet dhe realizohet zbatimi. Janë përshkruar kërkesat për raportim dhe janë përshkruar ciklet dhe mekanizmat për monitorim. Parimet udhëzuese ndihmojnë që të ekzistojë një strategji koherente dhe koncize, ndërsa objektivat e shpërfaqin motivimin e qeverisë për t'u marrë me përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave brenda afateve reale, por me ndryshime dhe rezultate përmbajtjesore.

5.1 Parimet

Ligji për Mbeturina tashmë e përcakton një tërësi parimesh që duhet ta udhëheqin sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Zhvillimi i qëndrueshëm i përfshin të gjitha planifikimet strategjike, ndërsa të tjerët trajtojnë aspekte më specifike të planifikimit të MMN-së.

Afërsia dhe vetëtrajtimi

Vigjilenca dhe parandalimi

Ndotësi paguan

Hierarkia e menaxhimit të mbeturinave

Përgjegjësia e prodhuesit


Siguria financiare

Qasja në informata

Mbrojtja e të drejtave në gjykatë

Përderisa legjislacioni tashmë jep udhëzime përmbajtjesore, kjo Strategji këto parime i përmbledh në gjashtë aspekte qendrore në të cilat do të përqendrohet vëmendja.

Qeverisja e mirë: Mbledhja e mbeturinave është njëri nga indikatorët kryesorë të një administrate publike funksionale. Si ofruesi aktual i shërbimeve me kapacitete operative përkatëse, ashtu edhe operatorët menaxhues privatë, të dyja palët janë duke e shfaqur kapacitetin teknik, menaxhues dhe financiar të administratave komunale dhe qendrore për t'u marrë me kërkesën e përditshme për shërbime. Qeverisja e mirë nënkupton përdorimin efikas të fondeve publike për ofrimin e shërbimeve adekuate, proceset vendimmarrëse transparente dhe pjesëmarrëse, institucionet publike të përgjegjshme dhe proaktive dhe një përafrim midis qytetarëve dhe administratës që u shërben atyre.



Standardet evropiane: Për anëtarësimin në BE kërkohet që të zbatohen të gjitha standardet evropiane që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave, duke përfshirë nivelet e shërbimit,

standardet e deponimit, objektivat e riciklimit dhe ripërtëritjes si dhe kërkesat për monitorim dhe raportim.

Ekonomia qarkore: Modelet lineare të prodhimit, konsumit dhe deponimit po zhduken gradualisht përderisa ne po bëhemi më të vetëdijshëm për burimet tona të kufizuara dhe ndikimet negative të modeleve të tilla. Përderisa Kosova është ende në proces të formimit të një sistemi gjithëpërfshirës të menaxhimit të mbeturinave në vend, aspektet kryesore të konceptit të ekonomive qarkore, siç është ripërtëritja e burimeve, zinxhirët e vlerave të produkteve dhe qarkullimi mes tjerash, do t'i udhëheqin sistemet e vendit drejt një menaxhimi më të qëndrueshëm dhe ekonomikisht më të favorshëm dhe më modern të burimeve të saj.

Parimi “ndotësi paguan” dhe përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit: janë shtypa rregullative që çojnë kah ekonomia qarkore Siç është përkufizuar tashmë në Ligjin për Mbeturina, parimi “ndotësi paguan” ia atribuon një përgjegjësi financiare të qartë financiare prodhuesit të mbeturinave, duke e stimuluar kështu reduktimin dhe riciklimin e tyre. Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit e shtrin këtë përgjegjësi në ciklin e plotë të prodhimit, konsumit dhe deponimit, duke e nxitur kështu motivimin për të dizajnuar dhe prodhuar produkte që janë të përshtatshme për riciklim apo ripërtëritje.

Zbatueshmëria: Ndonëse nuk është parim strategjik në vetvete, por duke e marrë pasur parasysh përvojën me zbatimin e strategjisë së mëparshme, zbatueshmëria e kësaj Strategjie do të sigurohet me vlerësime të hollësishme të shpenzimeve, me afate kohore reale dhe me një plan të veprimit gjithëpërfshirës për tri vitet e para të kësaj Strategjie.

5.2 Caqet

Për zbatimin e Strategjisë janë përcaktuar caqet në vijim. Këto caqe mund të shihen si qëllime të përkohshme për Kosovën në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE, si përgatitje për miratimin e objektivave specifike të korpusit ligjor të BE-së për menaxhimin e mbeturinave.

Objektivi	Indikatori	Baza për krahasim	Objektivi:	Viti
Shërbimet e mbledhjes së mbeturinave	Përqindja e popullsisë së përgjithshme me qasje në shërbime adekuate dhe të rregullta të mbledhjes e mbeturinave komunale	<70%	80%	2023
			100%	2026
Qendrat e menaxhimit të integruar të mbeturinave	Përqindja e gjithsej mbeturinave të ngurta komunale të prodhuara që menaxhohen në qendra të kontrolluara	< 40%	60%	2023
			80%	2027
			100%	2030
Mbeturinat e tjera	Janë krijuar qendrat e menaxhimit të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit	0	3	2023
	Plani i Menaxhimit të Mbeturinave të Kujdesit Shëndetësor	0	1	2022
	Plani i Menaxhimit të Mbeturinave të Nënprodukteve të Kafshëve	0	1	2022

	Plani i Menaxhimit të Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënit	0	1	2022
	Qendrat e trajtimit me kapacitet të mjaftueshëm për t'i përmbushur nevojat kombëtare të instaluar për MNRr-të, NPK-të dhe MKSh-të	0	3	2030
Ndërtimi i kapaciteteve	Realizohet programi i zhvillimit të kapaciteteve	1	1	2025
Njohja e sektorit	Industria e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave përfshihet në statistikat kombëtare	0	1	2023
	Themelohet organi përfaqësues i industrisë së menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave	0	1	2030
Hulumtimi dhe zhvillimi	Themelohet kursi (ose moduli) universitar për MIMN-në	0	1	2025
SIMN	Sistemi informativ për menaxhimin e mbeturinave është krijuar dhe funksionon	0	1	2023
Dhënia e licencave dhe lejeve	Dhënia e licencave dhe lejeve për qendrat e menaxhimit të mbeturinave	Pjesërisht	100%	2027
Mekanizmat e zbatimit	Plani i Menaxhimit të Mbeturinave Industriale	0	1	2022
	Planet e menaxhimit të mbeturinave të mëdha të industrisë	0	10	2022
	Janë krijuar mekanizmat dhe janë përcaktuar procedurat e zbatimit	0	1	2022
	Mekanizmat dhe procedurat e zbatimit zbatohen	0	<75%	2024
Vetëdijesimi dhe edukimi i publikut	Fushatat e vetëdijesimit realizohen dhe vlerësohet ndikimi i tyre	0	3	2024 2027-2030
Parandalimin e mbeturinave	Fillojnë projektet për parandalimin e mbeturinave	0	10	2024
Ripërdorimin dhe riciklimin	Mekanizmat e PZP-së aplikohen për fraksionet e produkteve/mbeturinave	0	4	2024

Përgatitja për hyrje në BE është çështje kritike për Kosovën gjatë viteve të ardhshme, çështje e cila është mbizotëruese në të gjitha fushat e politikave, përfshirë menaxhimin e mbeturinave. Pjesa më e madhe e përmbytjes së kësaj Strategjie ka të bëjë me përgatitjet e nevojshme për anëtarësim në BE.

Zhvillimi i sektorit të mbeturinave në Kosovë do të udhëhiqet nga politika dhe praktika evropiane. Kosova do t'i harmonizojë edhe sistemet e regjistrimit dhe raportimit të të dhënave me kërkesat e BE-s

5.3 Zbatimi, monitorimi dhe raportimi

Njëri nga parimet themelore të Strategjisë është zbatueshmëria e saj. Ajo bazohet në planin e veprimit që i është bashkangjitur këtij dokumenti dhe në të cilin përshkruhen të gjitha aktivitetet relevante për realizimin e objektivave të strategjisë, në një horizont kohor prej tri vitesh. Fushëveprimi është caktuar për t'u siguruar që fondet në dispozicion dhe alokimet financiare si dhe kapacitetet e nevojshme institucionale për zbatimin e Strategjisë janë rritur dhe përputhen me kërkesat për zbatim. Zbatimi i strategjisë është duke u degëzuar në disa nivele të përgjegjësisë dhe duke e mbuluar tërë vendin. Prandaj, monitorimi adekuat i progresit dhe drejtimi i vazhdueshëm është po aq i rëndësishëm dhe sfidues.

Meqë shumë veprime po zbatohen në nivel lokal me shumëllojshmërinë e gjerë të kapaciteteve të saj, informatat reale për progresin e arritur duhet të rrjedhin në mënyrë efikase midis organeve drejtuese dhe institucioneve zbatuese. Një aspekt tjetër që duhet marrë parasysh është disponueshmëria e fondeve. Në Planin e Veprimit që i është bashkangjitur Strategjisë janë shqyrtuar të gjitha burimet e financimit që janë përcaktuar aktualisht. Megjithatë, nëse gjatë zbatimit të strategjisë vihen në dispozicion burime të mëtejshme, planifikimi, zbatimi dhe monitorimi duhet të përshtaten në përputhje me rrethanat.

Zbatimi, monitorimi dhe raportimi i Strategjisë udhëhiqet dhe është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit ⁸.

MMPHI-ja është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e zbatimit, monitorimit dhe raportimit për zbatimin e kësaj Strategjie. Kjo përfshin edhe organin bashkërendues ndërministror, të përfaqësuar nga Grupi Punues për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta si dhe Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS-ja) dhe Komisioni për Planifikim Strategjik. Ajo po ashtu kërkon përfshirjen e sektorit të menaxhimit të mbeturinave, biznesit dhe industrisë, dhe qytetarëve. Partnerët zbatues kryesorë janë:

- Ministria e Pushtetit Lokal (MAPL), e cila e koordinon zhvillimin dhe mbështetjen e qeverisë për komunat, veçanërisht shtimin e aftësisë së tyre për të ofruar shërbime efektive
- Komunat e Kosovës, të cilat, sipas përkufizimit në Ligjin për Mbeturinave, janë përgjegjëse për krijimin e një sistemi të menaxhimit të mbeturinave brenda juridiksionit të tyre në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit, dhe përfaqësuesi i tyre në nivel kombëtar, Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK-ja);
- Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK-ja), në rolin e tij si rregullator mjedisor dhe i ngarkuar me detyrën për të raportuar për statusin e MMN-së në Kosovë (neni 14, 1.7-1.8 i Ligjit për Mbeturina);
- Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK-ja), e cila e mban përgjegjësinë për menaxhimin e impianteve të mbeturinave dhe pikat e deponimit përfundimtar në Kosovë;
- Kompanitë Rajonale të Mbeturinave (KRM-të), operatorët e licencuar në pronësi të qeverive komunale që ofrojnë shërbime rajonale të mbledhjes së mbeturinave, dhe përfaqësuesja e tyre në nivel kombëtar, Shoqata e Ndërmarrjeve Publike të Mbeturinave në Kosovë (PAMKOS-i)
- Operatorët e tjerë të licencuar që ofrojnë shërbime të MMN-së.

⁸ Udhëzimi Administrativ (GK) Nr. 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit është miratuar në mbledhjen e 39-të të Qeverisë së Kosovës me Vendimin Nr. 03/39 të datës 4.4.2018.

Plani i Veprimit, si mjet kryesor i zbatimit, i identifikon institucionet udhëheqëse dhe potencialisht mbështetëse për secilin veprim që përcaktohet në të. Prandaj, përgjegjësinë për zbatim, monitorim dhe raportim e mbart secili institucion i identifikuar. Megjithatë, MMPHI-ja, si organ bashkërendues, është përgjegjëse për bashkërendimin e përgjithshëm midis agjencive zbatuese dhe duhet të sigurojë që të realizohen afatet kohore dhe objektivat. Funkcionet e përgjithshme të qeverisë dhe institucioneve përkatëse të tyre nuk janë renditur në mënyrë specifike këtu (p.sh. planifikimi buxhetor dhe fondet e ndara nga Ministria e Financave). Funkcionet kryesore të të gjithë partnerëve zbatues janë paraqitur në tabelën në vijim.

Struktura e menaxhimit të zbatimit

Institucioni	Funksionet kryesore
MMPHI-ja	<ul style="list-style-type: none"> E harton Strategjinë dhe Planin e Veprimit I udhëzon të gjithë partnerët zbatues për përgjegjësitë e tyre në kuadër të Planit të Veprimit E bashkërendon përshtatjen e mbështetjes për zhvillim dhe financimit me Strategjinë dhe Planin e Veprimit E krijon një mekanizëm efektiv të monitorimit dhe raportimit dhe e siguron përdorimin e tij Mbledh informata nga partnerët zbatues për afatet kohore, objektivat dhe statusin e zbatimit I përgatit dokumentet e nevojshme për raportim (shih më poshtë) E organizon Grupin Punues për MMN dhe i ofron funksionet e sekretariatit E siguron shkëmbimin dhe bashkëpunimin midis të gjithë partnerëve zbatues I inicicion diskutimet për progresin e zbatimit dhe azhurnimin ose riplanifikimin e Planit të Veprimit
Grupi Punues për MMN	<ul style="list-style-type: none"> Kryen shkëmbime të rregullta për ta diskutuar ecurinë e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit I identifikon sfidat dhe vështirësitë dhe propozon masa korrigjuese për partnerët zbatues I shqyrton dhe miraton raportet e progresit dhe monitorimit E nxit bashkëpunimin midis të gjithë partnerëve zbatues
Zyra e Planifikimit Strategjik	<ul style="list-style-type: none"> U ofron mbështetje metodologjike MEA-së dhe partnerëve zbatues në hartimin e strategjisë, në monitorimi dhe raportim Merr pjesë në Grupin Punues për MMN I rishikon raportet dhe e bën një vlerësim strategjik të rrezikut dhe përshtatjes me aktet strategjike kombëtare gjithëpërfshirëse E integron ecurinë e strategjisë së MMN-së në raportimin kombëtar për dorëzim tek Komisioni i Planifikimit Strategjik
Komisioni i Planifikimit Strategjik	<ul style="list-style-type: none"> I shqyrton dhe miraton raportet e rregullta, nëse çështjet nuk i ka zgjidhur Grupi Punues për MMN Vendos për masat korrigjuese për ta siguruar zbatimin e shëndoshë të strategjisë I zgjidh çështjet në bashkërendim dhe vendimmarrje midis partnerëve zbatues, nëse zgjidhjet kanë dështuar në nivel të Grupit Punues për MMN
MAPL-ja	<ul style="list-style-type: none"> E mbështet shpërndarjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit nëpër komuna E bashkërendon mbështetjen e qeverisë për komunat në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit Merr pjesë në Grupin Punues për MMN

	<ul style="list-style-type: none"> I bashkërendon masat e zhvillimit të kapaciteteve për komunat e parashikuara në Planin e Veprimit me masa të tjera në mbështetje të administratave komunale E mbështet sigurimin e buxheteve adekuate në buxhetet komunale
Komunat	<ul style="list-style-type: none"> Në bazë të Strategjisë dhe Planit të Veprimit zhvillohen dhe zbatohen Planet Komunale ose Rajonale për Menaxhimin e Mbeturinave E sigurojnë zbatimin me kohë dhe efikas të veprimeve që u janë atribuar Raportojnë për progresin sipas kërkesës së MEA-së dhe AMMK-së la bëjnë me dije pengesat dhe sfidat ndaj zbatimit në kohë të veprimeve MEA-së dhe/ose Grupit Punues për MMN E sigurojnë bashkëpunimin e ngushtë me KMDK-në, KRM-në dhe/ose ofruesit e tjerë të shërbimeve Marrin pjesë në Grupin Punues për MMN-të, përmes përfaqësuesit kombëtar të tyre – AKK-së
AMMK-ja	<ul style="list-style-type: none"> E mbështet MEA-në në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave për zbatimin e Strategjisë I mbështet komunat në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave Merr pjesë në Grupin Punues për MMN
KMDK	<ul style="list-style-type: none"> Merr pjesë në Grupin Punues për MMN E sigurojnë zbatimin me kohë dhe efikas të veprimeve që u janë atribuar E siguron monitorimin dhe raportimin me kohë dhe gjithëpërfshirës për realizimin e veprimeve dhe për objektivat dhe performancën e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave la bëjnë me dije pengesat dhe sfidat ndaj zbatimit në kohë të veprimeve MEA-së dhe/ose Grupit Punues për MMN
KRM	<ul style="list-style-type: none"> Merr pjesë në Grupin Punues për MMN-të përmes përfaqësimit të tyre kombëtar nga PAMKOS-i E sigurojnë zbatimin me kohë dhe efikas të veprimeve që u janë atribuar E siguron monitorimin dhe raportimin me kohë dhe gjithëpërfshirës për realizimin e veprimeve dhe për objektivat dhe performancën e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave la bëjnë me dije pengesat dhe sfidat ndaj zbatimit në kohë të veprimeve MEA-së dhe/ose Grupit Punues për MMN
Ofruesit e shërbimeve	<ul style="list-style-type: none"> E sigurojnë zbatimin me kohë dhe efikas të veprimeve që u janë atribuar E sigurojnë raportimit me kohë dhe gjithëpërfshirës për performancën e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave

Kërkesat e monitorimit dhe raportimit

Sic është treguar në tabelën e mësipërme, monitorimi është një detyrë e shpërndarë për të gjithë partnerët zbatues të përfshirë. MMPHI-ja, me mbështetjen e Zyrës së Planifikimit Strategjik, do t'i krijojë udhëzimet dhe shabllonet e nevojshme të raportimit për t'u siguruar që të ketë të dhëna dhe informata gjithëpërfshirëse për t'i hartuar raportet e kërkuara në vijim për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Udhëzime të hollësishme janë dhënë në Doracakun për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit të tyre, i cili është nxjerrë nga Zyra e Planifikimit Strategjik.

Kjo Strategji ka një vlefshmëri prej dhjetë vitesh (2021-2030), me një azhurnim të propozuar pas pesë vitesh. Plani i Veprimit është i vlefshëm për tri vite (2021-2023) dhe do të azhurnohet dhe zgjerohet gradualisht, pas një cikli të vlerësimit dhe riplanifikimit afatmesëm.

Monitorimi/raportimi	Përshkrimi
Raporti gjashtëmuor për zbatimin e Planit të Veprimit	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i parë për zbatimin gjashtëmuor, raporti i dytë do ta mbulojë një periudhë prej 12 muajve • Do të shtjellohet nga MMPHI-ja, me përkrahjen e AMMK-së • Raporti për përfundimin e veprimeve, arritjet, arsyet për vonesa dhe vlerësimet e azhurnuara të rrezikut • E mbështet grupin punues të MEA-së dhe atë të MMN-së për të diskutuar dhe vendosur për masat korrigjuese • Miratohet nga Grupi Punues për MMN • Aprovohet nga Sekretari i Përgjithshëm i MEA-së
Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë	<ul style="list-style-type: none"> • Periudha e paraparë është fundi i tremujorit të parë të vitit pasues • Shtjellohet nga MMPHI-ja, me përkrahjen e AMMK-së • Raport për: <ul style="list-style-type: none"> ○ gjendjen e caqeve indikative për objektivat e strategjisë ○ gjendjen e realizimit të veprimeve ○ përdorimin e burimeve financiare ○ pengesat kryesore dhe masat korrigjuese • E mbështet grupin punues të MEA-së dhe atë të MMN-së për të diskutuar dhe vendosur për masat korrigjuese • Miratohet nga Grupi Punues për MMN • Aprovohet nga Sekretari i Përgjithshëm i MEA-së • Raporti vjetor në ZPS
Raporti përfundimtar për zbatimin e Strategjisë	<ul style="list-style-type: none"> • Brenda 3 muajve pas skadimit të Strategjisë ose si pjesë e ciklit të përditësimit pas 5 vjetësh • Si raport vjetor, por që i dorëzohet ZPS-së, duke përfshirë një vlerësim të hapave të ardhshëm • Aprovimi përfundimtar nga Komisioni i Planifikimit Strategjik
Vlerësimi afatmesëm i Planit të Veprimit	<ul style="list-style-type: none"> • Metoda e përzier e vlerësimit që do të bëhet pas zbatimit 18 muor, duke e mbështetur planifikimin elektronik dhe zgjaten e Planit të Veprimit • Drejtohet nga MMPHI-ja, me përkrahjen e ZPS-së • Themelimi i një task force për vlerësim • Raporti i dorëzohet Ministrit të MEA-së për miratim dhe Komisionit të Planifikimit Strategjik. • Të publikohet në faqen e internetit të MEA-së
Vlerësimi i Strategjisë	<ul style="list-style-type: none"> • Metoda e vlerësimit të përzier duhet të kryhet menjëherë pas përfundimit të Strategjisë ose si pjesë e ciklit të azhurnimit pas pesë viteve • Si më lart

6. Ndikimi buxhetor

Buxheti i Shtetit është instrumenti financiar kryesor i Qeverisë për t'i mbështetur prioritetet kombëtare për zhvillim. Sistemi dhe procesi i buxhetimit e përfshin buxhetin shtetëror vjetor dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-in), një plan shpenzimi ky trevjeçar i bazuar në politika.

Vlerësimi i ndikimit buxhetor kërkohet që të bëhet për Planin e Veprimit për Strategjinë sipas nenit 13 (2) të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015 për Vlerësimin e Ndikimit të Buxhetit për Nismat e Reja Qeveritare.

Manuali për vlerësimin e ndikimit të buxhetit dhe udhëzuesi metodologjik për koston e strategjive qeveritare, i hartuar nga Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ShRAP-ja). Këto udhëzojnë që të përdoren metodat në vijim:

- Qasja nga poshtë lart për vlerësimin e shpenzimeve, sipas objektivave, aktiviteteve, viteve dhe burimit të financimit. Kostoja inkrementale (shtesë) i nënkupton shpenzimet e kontributeve ose burimeve shtesë që duhet të shtohen përveç infrastrukturës ekzistuese për ta zbatuar një projekt apo strategji. Kostot inkrementale janë rezultat i planit të veprimit, ndërsa ato që ndërlidhen me ruajtjen e status kuosë nuk merren parasysh.
- Shpenzimet e komponentëve individualë u bashkohen kategorive buxhetore ekonomike për t'u inkorporuar në buxhet.
- Identifikohen burimet e financimit. Edhe nëse burimet e financimit nuk financohen nga shteti, Ministrisë së Financave duhet t'i bëhen me dije mundësitë e financimit.

Kategoritë buxhetore janë: pagat; mallrat dhe shërbimet; kapitali; subvencionet dhe transferet. Subvencionet dhe transferet i nënkuptojnë projektet kapitale të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për ndërmarrjet publike. Nuk ka të tilla në rastin e këtij Plani të Veprimit. Në vend të kësaj ofrohet asistencë teknike.

Formulari i Vlerësimin të Ndikimit të Buxhetit është paraqitur në tabelën në vijim. Periudha e planifikimit përkon saktësisht me periudhën e KASH-it 2020 -2022 . KASH-i përfshin:

- Investimet kapitale për kontejnerë, që tashmë janë përfshirë në buxhetin e shtetit për vitet 2020 dhe 2022
- Masat për përmirësimin dhe zgjerimin e deponisë së Pejës dhe masat për investim në mbrojtjen e mjedisit për deponinë e Prishtinës, të cilat janë përfshirë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për periudhën 2021-2022.

Asnjë investim tjetër kapital nuk është përfshirë në KASH 2020-2022.

Duke pasur parasysh rëndësinë gjithnjë e më të madhe të këtij sektori, mund të kërkohet krijimi i Fondit për Mjedisin (apo përndryshe e ndonjë llogarie alternative të veçantë në kuadër të Thesarit) për qëllime të menaxhimit të mbeturinave. Për mekanizmat e përzgjedhur për financimin e sistemeve të zgjeruara të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për ripërdorim dhe riciklim në veçanti mund të kërkohen llogari të ndara të dedikuara për t'i rrethuar fondet e mbledhura nga kjo industri dhe për të dëshmuar se ato janë përdorur saktësisht për qëllimin e tyre. Duhet të përcaktohet edhe një mekanizëm për financimin e shpenzimeve të mbylljes dhe kujdesit të pastajmë për deponitë.

Në tabelën e mëposhtme është ofruar një përmbledhje e realizimit të shpenzimeve të Planit të Veprimit sipas objektivit strategjik për secilin nga tri vitet e para të zbatimit.

Objektivat strategjike	2021	2022	2023	Gjithsej
Objektivi strategjik 1: Shërbimet dhe infrastruktura	6.134.673	19.244.330	19.749.890	45.128.892
Objektivi strategjik 2: Profesionalizimi i sektorit të mbeturinave dhe riciklimit	405,000	555,000	169,000	1.129.000
Objektivi strategjik 3: Rregullimi dhe kontrolli	963,000	4.339.000	3.670.250	8.972.250
Objektivi strategjik 4: Ekonomia qarkore	551,000	833,000	1.669.737	3.053.737
Gjithsej				58.283.879

7. Përafrimi me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

Në tetor të vitit 2015, me rastin e ditëlindjes së shtatëdhjetë të OKB-së, autoritetet e Kosovës, bashkësia ndërkombëtare dhe udhëheqësit e shoqërisë civile i lansuan **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm** (OZhQ-të) në Kosovë.

Disa nga indikatorët e OZhQ-ve ndërlidhen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me sektorin e mbeturinave, ndërsa në veçanti katër indikatorët në vijim janë synuar në mënyrë të veçantë në këtë Strategji; 11.6.1 për mbeturinat e ngurta komunale, 12.3.1 për mbeturinat e ushqimit, 12.4.2 për mbeturinat e rrezikshme dhe 12.5.1 për shkallën e riciklimit. Indikatorët strategjikë dhe specifikë të përfshirë në këtë Strategji synojnë drejtpërsëdrejti realizimin e OZhQ-ve.

Qëllimi i OZhQ-së	Caku i OZhQ-së	Indikator i OZhQ-së	Indikatorët e objektivave strategjike	Indikatorët e objektivave strategjike
11. Qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme	11.6: Deri në vitin 2030, zvogëlimi i ndikimit negativ në mjedis për kokë banori nëpër qytete	11.6.1: Përqindja e mbeturinave të ngurta komunale të mbledhura dhe të menaxhuara në qendra të kontrolluara	1. Shërbimet dhe infrastruktura	1.1. Ofrimi i shërbimeve të mbledhjes së MNK-ve 1.2. Zhvillimi i rrjetit të qendrave të menaxhimit të integruar të mbeturinave
			2. Profesionalizimi i sektorit	2.1. Ndërtimi i kapaciteteve profesionale 2,2. Caktimi i kodit industrial
12. Konsumi dhe prodhimi i qëndrueshëm	12.3: Deri në vitin 2030, përgjysmimi i mbeturinave të ushqimit për kokë banori në nivel	12.3.1: Indeksi Global i Humbjes së Ushqimit (IGHU)	1. Profesionalizimi i sektorit	2.3. Promovimi i hulumtimit dhe zhvillimit
			2. Ekonomia qarkore	4.2. Stimulimi e risive në

	global			parandalimin e mbetjeve
	12.4: Deri në vitin 2021, arritja e menaxhimit të shëndoshë mjedisor i kimikateve dhe të gjitha mbeturinave	12.4.2: Mbeturinat e rrezikshme të prodhuara për kokë banori dhe përqindja e mbeturinave të rrezikshme të trajtuara, sipas llojit të trajtimit	1. Shërbimet dhe infrastruktura	1.3. Zhvillimi i sistemeve dhe infrastrukturës për mbeturinat e tjera
			2. Rregullimi dhe kontrolli	3.1. Krijimi i sistemit informativ të menaxhimit të mbeturinave 3.2. Zgjerimi i dhënies së licencave dhe lejeve për menaxhimin e mbeturinave 3,3. Forcimi i mekanizmave të zbatimit
	12.5: Deri në vitin 2030, reduktimi i ndjeshëm i prodhimit të mbeturinave nëpërmjet parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit	12.5.1: Shkalla kombëtare e riciklimit, tonët e materialit të ricikluar	1. Ekonomia qarkore	4.1. Vetëdijesimi 4.3. Krijimi i sistemeve të ripërdorimit dhe riciklimit të bazuar në PZP

Burimet e financimit	2021				2022				2023			
	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Kapitali	Asistenca teknike	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Kapitali	Asistenca teknike	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Kapitali	Asistenca teknike
Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i një gjenerate të re të shërbimeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbeturinave	797,600	199,400	3,330,000	2,804,673	1,597,600	399,400	17,284,177	1,960,153	3,183,200	795,800	16,631,177	3,118,713
Ndarja e buxhetit të aprovuar (për përmirësimin e deponisë së Pejës dhe asaj të Prishtinës)	0	0	200,000	0	0	0	1,185,000	0	0	0	0	0
Ndryshimi në ndarjen e buxhetit të aprovuar (deponia e Gjilanit)	0	0	0	0	0	0	1,850,000	92,500	0	0	1,850,000	92,500
Burimi i financimit për të tjerat	tarifa e mbeturinave, buxhetet komunale	tarifa, buxhetet komunale	Granti	Granti i AT-së	tarifa e mbeturinave, buxhetet komunale	tarifa e mbeturinave, buxhetet komunale	Granti	Granti i AT-së	tarifa e mbeturinave, buxhetet komunale	tarifa e mbeturinave, buxhetet komunale	Granti	Granti i AT-së
Objektivi strategjik 2: Profesionalizimi i sektorit të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave	0	0	0	405,000	0	0	0	555,000	0	0	0	169,000
Ndarja e buxhetit të aprovuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ndryshimi nga ndarja e buxhetit të aprovuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Burimi i financimit për të tjerat	-	-	-	Granti i AT-së	-	-	-	Granti i AT-së	-	-	-	Granti i AT-së
OSP 3: Forcimi i	0	0	0	963,000	0	0	3,500,000	839,000	0	0	3,500,000	170,250

Burimet e financimit	2021				2022				2023			
	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Kapitali	Asistenca teknike	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Kapitali	Asistenca teknike	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Kapitali	Asistenca teknike
mekanizmave zbatues, përfshirë komunat dhe inspektoratet												
Ndarja e buxhetit të aprovuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ndryshimi nga ndarja e buxhetit të aprovuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Burimi i financimit për të tjerat	-	-	-	Granti i AT-së	-	-	Granti	Granti i AT-së	-	-	Granti	Granti i AT-së
Objektivi strategjik 4: Promovimi i vlerave dhe praktikave të një ekonomie qarkore	0	0	0	551,000	0	0	0	833,000	0	0	0	1,669,737
Ndarja e buxhetit të aprovuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ndryshimi nga ndarja e buxhetit të aprovuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Burimi i financimit për të tjerat	-	-	Granti	Granti i AT-së	-	-	Granti	Granti i AT-së	-	-	Granti	Granti i AT-së

8. Plani i veprimit

7.1 Plani i Veprimit 2021-2023

Plani i veprimit për realizimin e Objektivit Strategjik 1 (2021-2023)⁹

Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, indikatorët dhe veprimet	Vlera bazë	Cak i përkohshëm [2023]	Caku i vitit final [2030]	Rezultati				
1.	OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: ZHVILLIMI I NJË GJENERATE TË RE TË SHËRBIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS SË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETURINAVE								
1,1	Objektivi specifik: Ofrimi i shërbimeve të rregullta dhe të besueshme të mbledhjes së mbeturinave të ngurta komunale për tërë popullatën								
1.1	Indikator: Përqindja e popullsisë së përgjithshme me qasje në shërbime adekuate dhe të rregullta të mbledhjes e mbeturinave komunale	74% në vitin (2018) ¹⁰	80%	100%	E tërë popullata ka qasje në shërbime adekuate dhe të rregullta të mbledhjes e mbeturinave				
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati	Referenca në dokumente
			2021	2022	2023				
1.1.1	Zbatimi i granteve të performancës sipas IKP-ve për shërbimet e mbeturinave	2023 TM4	2,333,000	2,333,000	2,334,000	Granti i asistencës teknike dhe MMPHI-ja	MMPHI-ja (I), MAPL-ja	Grantet e performancës i mbështesin komunat me performancë të	IPA

